

Dr. Sabri Saliu

GJUHA LATINE

**Për shkollat e mesme - Gjinnazet e reformuara
(për mësim vazhdues)**

ÇABEJ

2004

PARATHËNIE

Ky tekst shkollor është përpiluar sipas programit mësimor të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës së Republikës së Maqedonisë, për gjimnazet e reformuara në përgjithësi me mësim në gjuhën shqipe në R. e Maqedonisë. Ky material mësimor është paraparë dhe është përpiluar për mësim vazhdues në të gjitha drejtimet e gjimnazit të reformuar, me mësim dy orë në javë (72 orë gjatë tërë vitit shkollor).

Materiali i shtruar në këtë tekst është paraparë si i kompletuar në të gjitha fushat e gjuhës dhe letërsisë latine, duke paraparë kulturën romake, fushën e drejtësisë dhe disa njohuri edhe për fushën e mjekësisë.

Teksti për bazë ka ushtrimet për të gjitha drejtimet e gjimnazit të reformuar si dhe pjesa e gramatikës së plotë të latinishtes për mësimin vazhdues të kësaj gjuhe duke përfshirë materialin e sintaksës së rasave, sintaksës së foljes dhe sintaksën e fjalisë. Po ashtu janë dhënë sqarime për secilën njësi mësimore, ku përputhet edhe pjesa e gramatikës përkatëse.

Libri mbështetet në tekstet dhe metodat e deritanishme të mësimin të gjuhës latine që përdoret në vendin tonë dhe në botë, por për nga përgaditja dhe metodologjia shkencore dhe pedagogjike është më i përsosur, pasi që i tejkalon në disa drejtime dhe në raste më të qarta udhëzohet për lehtësim mësimi i gjuhës latine në variante dhe të gjuhës shqipe.

Është plotësuar me citate të shumicës së autorëve të vjetër latin dhe me disa kuriozitete që i nevojiten nxënësve që mësojnë këtë lëmi. Sqarime të ndryshme janë dhënë edhe në fjalorin latinisht-shqip si dhe shqip-latinisht.

Mendoj se ky libër si i kompletuar do t'u ndihmojë nxënësve shqiptar për të shprehur një interes të posaçëm për mësimin e gjuhës latine dhe antikitetin e saj, qoftë në fushën e gjuhësisë, letërsisë dhe të kulturës së vlefshme dhe të pashlyer gjer më tani.

Autori,

HYRJE

ROMA DHE GJUHA LATINE

Legjenda thotë se më 753 para erës sonë u krijua prej Romulit në Laciun të gadishullit italik qyteti i Romës, që do të rritej më vonë deri në një perandori, më e madhja e antikitetit evropian, që do t'i vinte vulën e saj çdo aktiviteti ekonomik, politik, kulturor e shkencor të botës së vjetër dhe që do të ndryshonte edhe hartën gjuhësore të Evropës.

Roma e vogël, pasi u forcua ekonomikisht dhe u organizua politikisht, nënshtrroi, në fillim, popullsinë e Laciun dhe më vonë pjesën më të madhe të territoreve të Gadishullit italik. Pas shekullit të dytë para erës sonë romakët iu sulën Ballkanit e pastaj me rradhë vendeve të tjera rreth Mesdheut e dolën deri në Gali. Krijuan kështu perandorinë më të madhe të antikitetit që përfshinte vendet më të zhvilluara të botës antike, prej të cilave ata trashëguan çdo gjë pozitive që kishin arritur në fusha të ndryshme: në ekonomi, në shkencë, në art etj. Mbi këto, ata ngritën shkencën, artin dhe kulturën e tyre, që e përhapën pastaj në të gjithë botën antike dhe ia përcollën botës së sotme.

Në vitin 395, për t'u qeverisur më mirë, Perandoria Romake u nda në dy pjesë: në Perandorinë Lindje dhe në Perandorinë Perëndim. Më 476 Roma pushtohet nga barbarët dhe Perandoria e Perëndimit shkatërrohet. Perandoria e Lindjes vazhdon të jetojë deri më 1453. Kur hordhitë osmane pushtojnë Bizantin dhe shkatërrojnë përfundimisht edhe Perandorinë e Lindjes.

Bashkë me pushtimet, romakët përhapën edhe gjuhën e tyre, e cila u bë gjuhë e perandorisë dhe u imponua në vendet e pushtuara derisa u bë gjuhë e popujve të tyre.

Gjuha romake ose latine u përhap në dy drejtime: si gjuhë e folur dhe si gjuhë e shkruar e administratës. Si gjuhë e folur, ajo u përhap në shumicën e provincave romake dhe mbi këtë bazë lindën gjuhët e sotme neolatine: italishtja, frëngjishtja, spanjishtja, portugalishtja, rumanishtja, retromanishtja, katolonishtja, provansalishtja, sardishtja.

Si gjuhë e shkruar e administratës, ajo u ndërpre pas rënies së Perandorisë Romake të Perëndimit, por vazhdoi të përdorej deri në Mesjetën e vonë si gjuhë e shkencës dhe e kulturës evropiane. Rëndësia e kësaj gjuhe, veç si bartëse e një kulture dhe një shkençe, që u bë bazë e zhvillimeve të sotme, duket edhe në faktin që ajo la gjurmë të thella në terminologjinë e shumë shkencave. Këto janë arsye të mjaftueshme që latinishtja të vazhdojë të studjohet në shkolla të niveleve të ndryshme të atyre vendeve, gjuha e të cilave nuk ka lidhje prejardhjeje me latinishten.

Dokumentet e para të gjuhës latine, datojnë aty nga shekulli VII para erës sonë. Po, sigurisht, ajo filloi të përpunohej dhe u shëndërrua në gjuhë komunikimi e kulture kur Roma u forcua dhe u shëndërrua në një republikë të fortë. Si gjuhë zyrtare e shtetit roman, e shkruar dhe e folur, ajo jetoi një periudhë mjaft të gjatë,

më shumë se njëmijëvjeçare. Gjatë kësaj kohe ajo u pasurua e u përpunua si gjuhë letrare, por edhe u zhvillua e u ndryshua nën ndikimin e gjuhës së folur të popullsisë romane. Dallohen tri periudha të zhvillimit të saj:

1) Periudha e parë është periudha paraklasike ose periudha arkaike, që përfshinë shekullin III-I p. e. sonë. Dokumentet e shkruara që na kanë arritur janë veprat e komediografëve të vjetër romak, si Plauti (254-184) dhe Katoni (234-149), leksiku dhe struktura fonetike e gjuhës së këtyre dy komediografëve u afrohen normave të latinishtes klasike. Sidoqoftë gjuha latine e kësaj periudhe dallohet për karakterin e saj më konservues: mbarresat rasore dhe gjatësitë e zanoreve janë ruajtur mirë.

2) Periudha e dytë është periudha klasike latine e cila përfshinë shekullin I para erës sonë deri në shekullin e I të erës sonë.

Në këtë periudhë kanë ushtruar aktivitetin e tyre një sërë poetësh, prozatorësh, filozofësh dhe shkencëtarësh. Në saje të punës së tyre u arrit të krijohet gjuha letrare romake, me të cilën u shkrua një letërsi artistike mjaft e pasur. Përfaqësues më të shquar të kësaj periudhe janë: Jul Qesari, Ciceroni, Salusti, Tit Livi, Horaci, Ovidi, Virgjili etj. poetë e prozatorë që dhanë kryevepra. Nga pikëpamja gjuhësore, kjo periudhë shënon fillimin e rënies së mbaresave të lakimit emëror dhe rrafshimin e gjatësisë së zanoreve, gjë që solli si pasojë mjaft ndryshime të rëndësishme në sistemin morfologjik e sintaksor të latinishtes.

3) Periudha e tretë është periudha pas klasike ose periudha e perandorisë së hershme, ku përfshihet shekulli i I deri te shekulli II i erës sonë. Përfaqësues më të shquar të kësaj periudhe janë shkrimtarë e filozofë, si: Luci Seneka (1-65), Fedri, Juvenali (rreth viteve 60-140), Plini Plak (23-79) etj. Në këtë periudhë u thelluan më tej proceset gjuhësore të nisura që në periudhën klasike.

ROMA DHE ILIRËT

Në shekullin e dytë para erës sonë Roma i ktheu sytë nga Ballkani. Pushtimi i tokave të ilirëve ishte e domosdoshme për ta vazhduar ekspansionin në vende të tjera të Ballkanit, të Azisë së Vogël e më tej. Pas një sërë luftërash me shtetin ilir të taulantëve, Roma arriti t'i mundë ilirët. Filloi për ta një pushtim i gjatë më parë nën romakët e, pas ndarjes së Perandorisë, nën Bizantin.

Ilirët nuk iu nënshtruan pushtimit romak, bënë një sërë kryengritjesh e u tërhoqën në male, e kjo, siç duket, qe arsyeja që ilirët e jugut nuk u romanizuan veçse pjesërisht në vendet fushore. Kjo popullsi ilire e ruajti identitetin e saj deri në ditët e sotme si shqiptarë.

Marrëdhëniet iliro-romake, të cilat më përpara ishin të kufizuar për shkak të ndarjes nga deti, pas pushtimit u intensifikuan. Pasojë e këtyre marrëdhënieve ishte edhe ndikimi i latinishtes mbi ilirishten. Përdorimi i latinishtes si gjuhë e administratës, si gjuhë e kulturës dhe si gjuhë e kishës nuk mund të mos linte gjurmët e saj në gjuhën e vendësve. Një numër i madh fjalësh u huajtën nga vendësit, fjalë nga sfera të ndryshme të jetës së përditshme dhe të jetës shoqërore dhe shpirtërore, të cilat u bënë pronë e ilirishtes dhe u trashëguan nga shqipja. Por është një fakt i pranuar tashmë prej të gjithësh që ky ndikim nuk u shtri përtej sferës së lekskut. Siç e ka vënë në dukje Pedersen, në morfologji e në sintaksë ndikimi latin është pothuajse zero. Sidoqoftë, këto huazime nga latinishtja janë një lëndë shumë e vlefshme për të parë zhvillimin e shqipes për atë periudhë që s'e ka të dokumentuar me vepra të shkruara. Ato na ndihmojnë të vendosim disa shkallë të zhvillimit të shqipes, të kalimit nga ilirishtja në shqip.

Rëndësi të veçantë kanë në këtë drejtim gjithashtu edhe monumentet kulturore, historike dhe mbishkrimet e shumta që kanë arritur deri në kohën tonë dhe që na jepen në këto dy gjuhë klasike (greqisht dhe latinisht).

Në gjuhën latine i kanë shkruar veprat e tyre edhe humanistët tanë shqiptarë si Marin Barleti (fundit i shekullit XV pas vitit 1512), i cili më 1505 botoi veprën e vet "Mbi rrethimin e Shkodrës" ("De obsidione Scodrensi") dhe më 1508-1510 botoi veprën tjetër të vet të pavdekshme "Historia e jetës dhe e trimërive të Skënderbeut, princit të epirotëve" (De vita, moribus ac rebus praecipue adversus turcas gestis Georgii Castrioti clarissimii Epirotarum principis) vepër me vlerë të madhe kombëtare, shkruar latinisht e përkthyer në të gjitha gjuhët evropiane si dhe Marin Beçikem; (1468-1526) humanist tjetër shqiptar, i cili na ka lënë shumë shkrime në gjuhën latine. Rëndësi tjetër kanë veprat Gjon Buzukut (shek. XVI), Lekë Matrëngës (1560-1619), Pjetër Budit (1566-1622), Pjetër Bogdanit (1625-1689), Frang Bardhit (1606-1643), i cili hartoi edhe fjalorin latinisht-shqip ("Dictionarium latino-epiroticum") etj.

Rëndësia e njohjes së gjuhëve klasike dhe në mënyrë të veçantë njohja e latinishtes është me vlerë. Latinizmat dhe termat greko-latinë ne ndeshim jo vetëm në literaturën tekniko shkencore, por edhe në jetën tonë të përditshme. Çdo ditë përdorim shumë latinizma por pa menduar shumë për prejardhjen dhe kuptimin e tyre fillestar.

Universitet - universitas; institut-institutum; student; professor; kulturë-cultura; literaturë-littera; fakultet - fakultas; laborator - laboratorium; laborant - laborans; konspekt- conspectus; konsultim - consultum etj.

Me gjuhën latine ndeshemi në shkencat shoqërore, në gazetari, mbledhje etj. P.sh. klasë - classis; presidium - praesidium; artikull - articulus; materie - materia; reformë - reforma; republikë - republica; legal - legalis etj. Me latinizma ndeshemi edhe në degë të ndryshme të teknikës: motor-motor; armaturë-armatura; konstruktion-constructio; kalorifer-calorifero; frigorifer-frigus-fero; radio-radius; instrument-instrumentum; aparat-aparatus; fabrikë-fabrica; industri- industria; difekt-defectus; normë-norma; project-projectum; plus-plus; minus-minus etj.

Në astronomi emrat e planetëve janë emra mitologjike të perëndive romake psh. Mercur-Mercurius; Venera-Venus; Mars-Mars; Jupiter-Juppiter; Saturn-Saturnus; Neptun-Neptunus etj.

Latinizma gjejmë edhe në emërtimin e muajve dhe në emrat e njerëzve si psh. Janar - Janarius; Mars-Martius etj. Mandej fjala kalendar-Calendarium etj. pra mësimi i gjuhës latine jep një ndihmesë shumë të madhe në çdo sferë të jetës. Sidomos tek ne shqiptarët rëndësi të posaçme përveç mjekësisë, farmacisë, stomatologjisë, vlerë të madhe ka në historinë dhe në gjuhësi, ku nëpërmjet të njohjes së gjuhës latine studjojnë historinë e vjetër të popullit shqiptar dhe historinë e gjuhës shqipe.

KULTURA DHE QYTETËRIMI ROMAK

Historiku i gjuhës latine

Gjuha latine hyn në grupin e gjuhëve indoevropiane ku bën pjesë edhe gjuha jonë shqipe. Tani është gjuhë e vdekur sikurse indishtja e vjetër, sankstrishtja, gjuha e vjetër greke, persishtja e vjetër, egjiptishtja e vjetër. Dikur gjuha latine ka qenë gjuhë e gjallë. Siç janë sot gjuhët e reja dhe gjuha jonë shqipe.

Gjuhën latine në fillim të mijëvjeçarit të parë para erës sonë flisnin banorët e laciumit (latium), të krahinës qendrore të gadishullit Apenin, që shtrihej me një sipërfaqe prej 2000km² ndërmjet Etruris dhe Kalabrisë. Banorët që jetonin në këtë krahinë quheshin Latin (Latini) dhe gjuha a etyre gjuha latine (Lingua latina). Qendra kryesore e këtij populli u bë qyteti i Romës (Roma), ku ka një histori dhe një kulturë shumë të vjetër dhe të pasur. Sa i përket legjendës për themelimin e qytetit të Romës datojnë aty ka shekulli i VII (754-753) para erës sonë. Dhe më vonë ky fis mori emrin italik që u bashkua me Romën dhe së bashku u quajtën Romak (Romani). Dhe pas zhvillimit të mëtejshëm Roma u bë kryeqendra e popullit romak dhe e kulturës së tij.

Me zhvillimin e mëtejshëm, duke pasur parasysh pozitën e favorshme të saj. Roma u rrit shumë shpejt në rrugën e zhvillimit të mëtejshëm. Kështu periudha e parë e egzistencës së Romës quhej periudha mbretërore që zgjati 250 vjet. Pas mbarimit të kësaj periudhe 250 vjeçare Roma u pushtua prej Etruskëve dhe gjuha e tyre la gjurma të thella në gjuhën latine dhe në kulturën romake, mirëpo akoma deri më sot për gjuhën e Etruskëve kemi njohuri të pakta. Sundimi i Etruskëve nuk zgjati shumë kështu ata u dëbuan me anën e kryengritjeve të armatosura, si pasoje e së cilës në Romë u vendos republika (VI-I para erës sonë).

Dihet se në fillim gjuha latine ka qenë gjuhë e vetme e latinëve (romakëve), mirëpo pasi filluan të bien edhe fiset tjera që ndodheshin në gadishullin apenin nën zgjedhjen romake ajo u përhap mbarë dhe gradualisht u bë mjet komunikimi gati në tërë Italinë e bashkuar (shekulli i parë i erës sonë).

Për historikun dhe për egzistimin e kësaj gjuhe ose të këtij populli, dëshmi të sakta dhe të shkruara i hasim të shekullit VII dhe fillimit të shekullit V para erës sonë. Mendohet se në krahinën e laciumit janë folur edhe gjuhë të tjera, sikurse edhe në krahinat tjera të Italisë së atëhershme. Gjuhtarët mendojnë se prejardhja e këtyre gjuhëve shumë të afërta është prej gjuhës hipotetike italike, ku kuptohet një gjuhë akoma më e vjetër italo-kelte, që ishte motër me greqishten, shqipen, gjermanishten etj.

Në bazë të mbishkrimeve të gjetura vërehet se përmenden disa dialekte të ndryshme, mirëpo nuk kemi raste konkrete për definimin e tyre, prandaj dimë shumë pak për umbrishten, oskishten, etruskishten etj., që vetëm gjuha latine nga këto arriti të bëhej gjuhë letrare dhe u bë zyrtare në gjithë Italinë. Mirëpo më vonë kjo mori përmasa të mëdhaja, shekulli i parë i erës sonë latinishtja kaloi kufijtë e gadishullit Apenin u përhap në Evropë, Afrikë dhe në Azi dhe më vonë u bë gjuhë botërore.

LETËRSIA ROMAKE

Letërsia romake u zhvillua relativisht vonë. Ajo lindi aty nga mesi i shekullit III, në procesin e helenizimit të kulturës romake, atëherë kur Roma ishte bërë përfundimisht një polis skllavopronar dhe kishte mundur ta shtrinte pushtetin e vet në tërë Italinë.

Periudha e rënies së rendit fisnor dhe e lindjes së shoqërisë me klasa periudh që në Greqi njohu një lulëzim të madhë letrarë, për letërsinë romake kaloi pothuaj pa asnjë fryt. Kjo prapambetje e letërsisë në krahasim me tempin e saj në paaftësinë e romakëve për të krijuar vepra arti, siç pohojnë ndonjëherë studiues të ndryshëm, por në kushte specifike të historisë së hershme të Romës.

Letërsia klasike romake duhet konsideruar si një vazhdimësi e natyrshme e letërsisë së lashtë greke dhe organikisht e lidhur me të. Pra kjo letërsi zë fillë në kushte të marrëdhënieve skllavopronare të shoqërisë latine. E vërteta është se autorët romak i imituan ata grek, por në të njëjtën kohë dijtën që letërsinë e tyre t'ia japin edhe karakterin kombëtarë romak, mandej duke krijuar edhe një varg llojesh e nënlllojesh, sidomos të poezisë lirike.

Të gjithë këto faktorë dhe disa ndikime u pasqyruan veçanërisht në poezi e cila për shumë kohë vazhdoi të ruaj karakterin folklorik. Edhe në Romën e lashtë ashtu edhe në Greqi, kënga pati karakter sinkronik, ajo lindi si nevojë praktike për të shoqëruar proceset e ndryshme të punës, akte e ceremoni fetare.

Përmendoret më të lashta të poezisë romake janë himnet fetare, që janë ruajtur në shërbimet e priftërinjve - falltarë.

Në muajin mars, maj dhe tetorë priftërinjtë iu drejtoheshin hyjnive me anë të riteve të tyre. Këtu flitet për këngë të ndryshme me karakter pagan, ninulla dhe këngë për fëmijë. Pra nëpër të gjitha këto raste ritmi dhe metri i vargut kanë frymën e poezisë popullore.

Burimet e vjetra latine përmendin edhe një lloj tjetër këngësh folklorike, këngët e gostisë. Ku për këto të dhëna të sakta jep poeti i mirënjohur Katoni.

Kurse te veprat e historianëve romak ne gjejmë një paraqitje mjaft sistematike të jetës së komunës romake, duke filluar nga momenti i themelimit hipotetik i saj. Sidomos shumë gjëra nga tregimet e historianëve romak duket se kanë karakter legjendar. Gojëdhënat për dy binjakët që themeluan Romën. Romulin dhe Remin, për vajzën Tarpea etj.

Kështu me legjendat e vendit u bashkuan edhe legjendat greke, të cilat depërtuan më vonë plotësisht.

Më vonë kur në Romë u zhvillua letërsia artistike proza mbahej si më e përshtatshme për aristokratët sesa poezia.

Kështu poezia nuk nderohej - shkruan për kohë e lashtë shkrimtari romak Katoni.

Mirëpo poetët e parë romak zakonishtë kanë qenë njerëz me pozitë të lartë shoqërore dhe shpesh jo edhe qytetar romak, por të ardhur nga krahinat e tjera të Italisë ose skllavë të liruar. Në fillim letërsia romake pati karakter të theksuar imitimi. Shkrimtarët riprodhuan modelet greke në formë përkthimi ose përpunimi. Natyrisht ata u përpoqën të zgjidhnin nga letërsia greke ato vepra që u përshtaten

kërkesave ideologjike të shoqërisë së tyre dhe nivelit kulturor të popullit. Për këtë arsye u drejtuan kryesisht nga gjinitë e lashta letrare, karakteristike për periudhën.

Periudhat e gjuhës latine

Shkenca latine dallon katër periudha të rëndësishme:

1. Periudha paraklasike e gjuhës latine ose periudha arkaike.
2. Periudha klasike e gjuhës latine,
3. Periudha pasklasike e gjuhës latine
4. Periudha e vonë ose Gjuha e vonë.

1. Periudha paraklasike e gjuhës latine ose periudha arkaike; kjo periudhë daton që nga shekulli i III deri te fillimi i shekullit të I para erës sonë. Si autorë ose përfaqësues më të përmendur në këtë periudhë i hasim komediografin Plauti (Titus Macer Plautus) i cili ka jetuar rreth viteve 254-184 para erës sonë.

Te veprat e Plantit leksiku dhe struktura fonetike e tij i afrohen normave të gjuhës klasike latine. Po ashtu hasim edhe veprat mbi problemet e shkancave të natyrës dhe të mjekësisë "De re rustica" e Katonit plak (Cato Major) i cili ka jetuar 234-149 para erës sonë. Te vepra e tij hasim shumë fjalë të natyrës mjekësore, të mara nga gjuha e folur.

2. Periudha klasike e gjuhës latine: Kjo periudhë daton që nga shekulli i I para erës sonë deri në fillimin e shekullit I të erës sonë. Në këtë periudhë hasim një numër të madhë poetësh, prozatorësh, filozofësh dhe shkencëtarësh që këto së bashku arritën të krijonin gjuhën letrare latine dhe një letërsi shumë të pasur me vlera artistike. Si përfaqësues më të përmendur të kësaj periudhe i hasim Ciceronin (Marcus Tullius Cicero) i cili jetoi nga viti 106-48 para erës sonë, Jul Cezari (Gaius Julius Caesar) jetoi nga viti 100-44 para erës sonë. Këta të dy konsiderohen si themelues të prozës artistike romake dhe vendosës të normës së prozës. Mandej kësaj periudhe i bashkangjiten historianët e famshëm romak: Salusti (Gaius Salustius Crispus) vitet 65-35 para erës sonë. Tit Livi (Titus Livius) vitet 59 para erës sonë -17 të erës sonë, mandej poetët Virgjili (Publius Vergilius Maro) vitet 70-19 para erës sonë, Horaci (Quintus Horatius Flaccus) vitet 65-8 para erës sonë, Ovidi (Publius Ovidus Naso) vitet 43 para erës sonë - afër vitet 18 të erës sonë etj., të cilët krijuan, një normë të tillë të gjuhës poetike letrare.

Kontribut të madh këto dijetar i dhanë pastrimit dhe lëvrimin të gjuhës latine, poetët e kësaj periudhe u pajtuan plotësisht me prozatorët. Këtë qëndrim përveç këtyre e kishin edhe Terenci, Eni dhe Lukreci, që ishin përfaqësues të filozofisë materialiste të kohës antike. Kështu këto dhan një kontribut të madh në krijimin e terminologjisë filozofike materialiste, duke na dhënë në gjuhën latine filozofinë materialiste të Epikurit grek në veprën e tij "De rerum natura."

3. Periudha pasklasike e gjuhës latine ose periudha e perandorisë së herët; kjo periudhë daton nga fillimi i shekullit të I deri në shekullin e II të erës sonë. Kjo periudhë tregon zhvillimin e gjuhës latine pikërisht të letërsisë artistike dhe shkencore, fusha kryesore e të cilave ka qenë teoria dhe praktika e artit oratorik. Kjo periudhë sjellë shkrimtar dhe filozof, që më të përmendurit janë: Luci

Seneka (Lucius Anneaus Seneca) fillimi i shekullit të I- viti 65 i erës sonë, fabulistin romak Fedri (Faedrus) fundi i shekullit të erës sonë, satiristin juvenal (Decius junius juvenalis) afer vitit 60-140 të erës sonë, epigramatistin romak Markiali (Marcus Valerius Martialis) afër vitit 40-104 të erës sonë etj.

Veprat më të rëndësishme të kësaj periudhe i hasim "Historia naturalis" e Plinit Plak (23-79), që jep njoftime të gjëra mbi shkencën natyrore dhe shoqërore, dhe veprën "Naturales quaestiones" të Luci Senekës (4-65).

4. Gjuha latine e vonë; kjo periudhë përfshinë shekullin e III-IV të erës sonë. Kjo periudhë konsideron lindjen e shteteve barbare dhe dukurit që pregadisnin kalimin e gjuhëve të reja neolatine.

Pas krijimit të Romës si një shtet skllavopronar të fuqishëm në Mesdhe, ku Roma vuri nën sundimin e vet shumë territore të Evropës juglindore, në Afrikën veriore dhe në Azinë e vogël gradualisht filloj dominimi i gjuhës latine në përdorim si gjuhë komunikimi dhe e administratës. Kjo u përhap në fillim nga ushtarët, tregëtarët, gramaticientët, detarët, skllavërit e arratisur etj, kështu depërtoj gati në të gjitha sferat e jetës shoqërore dhe ekonomike.

U përhap në Iliri, Greqi, Kartagjenë, Egjipt, Siri etj, mandej në fiset më pak të zhvilluara, te Galët, Iberët, Daket, Fenikasit etj. Mandej në territoret e shteteve të sotme të Spanjës, Portugalisë, Francës, Zvicrës, në vendet e ulta Holandë, pjesën e Gjermanisë, Anglisë jugore, Çekoslovakisë, Hungarisë, Rumanisë, vendet e ish-Jugosllavisë, Bullgarisë, Shqipërisë, Greqisë, Turqisë, Libanit, Sirisë, Palestinës, Egjiptit, Libisë, Tunizisë, Algjerisë etj.

Mirëpo pas ndarjes së perandorisë Romake në dy pjesë (395), Roma u nda në dy perandori: në Perandorin e Lindjes dhe të Perëndimit. Këtu ndodhen disa ndryshime, në Perandorinë e Lindjes - Bizantit pozitën sunduese e kishte zënë gjuha greke, ndërsa në atë të perëndimit gjuha latine. Këtu fillonë edhe rënja e gjuhës latine në aspekt komunikimi dhe më vonë këto vende filluan të zëvendësojnë përdorimin e gjuhëve të veta.

Gjuha latine, për pasoj të situatave të ndryshme politike duke u përhapur në territore shumë të mëdha dhe në popullsi me përbërje etnike të ndryshme, ka filluar të humbas pak nga pak pastërtin, seriozitetin dhe rreptësinë e saj klasike. Veç kësaj, nën ndikimin e lidhjeve akoma më të gjëra me popujt që e rrethonin botën antike, gjuha latine pësoi ndryshime edhe më të mëdha. Në të filluan të depërtonin elemente të huaja, elemente popullore dhe elemente të gjuhës së folur.

Në shekullin e V (të erës sonë), pas rënies së Perandorisë së Perëndimit dhe pas dyndjeve të fiseve barbare Roma e humbi rolin e vet si udhëheqëse politike dhe si qendër ekonomike dhe administrative. Në shekullin e VI deri në shekullin e VIII (të erës sonë), çdo krahinë e ish Perëndorisë Romake bënte jetë më vete, të veçuar dhe të pavarur.

Shfaqja e gjuhëve neolatine (ose romane) i takon për afërsisht shekullit IX të erës sonë. Në të bëjnë pjesë gjuhët e sotme: Italishtja, spanjolishtja, portugalishtja, frëngjishtja, rumanishtja, dhe retroromanishtja.

Periudha e humanizmit

Shkencëtarët humanistë të Rilindjes kanë bërë një luftë të madhe aktive për gjuhën klasike latine, për pastrimin e saj nga vullgarizmat. Kështu që të gjithë shkencëtarët e periudhës së Rilindjes dhe të kohës së re veprat e tyre i botonin në gjuhën latine. Më të përmendur janë: filologu humanist holandez Erazm Roterdami (1466-1536), filologu dhe humanisti gjerman Reihlin (1455-1528), mendimtarin Tomas Mor (1478-1535), mjekët dhe anatomistët italianë Vazali (1514-1564), dhe Eustakio (1510-1574), Tommazo Campanella (1568-1639), biologu dhe anatomisti italian Malpigi (1628-1694), mjeku anglez Harvej (1578-1657), Nikolla Koperniku (1473-1543), filozofi Dekartin (1596-1650), Bekoni (1561-1626), Gobbsin (1588-1670), Spinoza (1632-1677), Galileu (1564-1642), Njutoni (1642-1727) etj.

E DREJTA ROMAKE

KODI I PAPIRIANIT

ROMULI

Te romakët Romuli ka qenë themelues i të drejtës patronale, ku patricët u shpjegonin të drejtën klientëve të vet që në vend të tyre të udhëhiqnin kontestin, të u ndihmohet nëse atyre u bëhet ndonjë padrejtësi dhe të asistojnë në punët e tyre juridike, kurse klientët duhet të ndihmojnë patronët e tyre në martesat e vajzave të tyre, dhe në rast se kanë nevojë të kthejnë kur ato ose vetë ose fëmijët e tyre rrëmbehen nga armiqët të paguajnë borxhin e tyre nëse janë të gjykuar për borxh ose për të dhëna publike.

Numa Pompili

Numa Pompili ka caktuar që ai që ka lëvruar mexhën së bashku me qetë të mallkohet.

Ligji mbretërorë ka ndaluar që të varroset gruaja që ka vdekur shtatzënë para se t'i nxirret fryti. Kush vepron ndryshe, do të konsiderohet se ka ndërprerë shpresën e përtërirjes.

Tul Hostili

Ligji është aprovuar me ate rast sipas së cilit kur dikujt i lindin tre djem bineq, mund deri te mosha e tyre e pubertetit të marrë nga shteti alimentacion për mbajtjen e tyre.

Kodi i Justinianit

Ulpiani - nga libri i parë i rregullave

Drejtësia është një dëshirë e vazhdueshme dhe e përhershme që secilit ti jepet e drejta që i takon. E drejta urdhëron të jetosh ndershmërisht, të mos e dëmtosh tjetrin, secilit ti jepet çka i takon.

Shkenca juridike është njohja e gjësendeve hyjnore dhe njerëzore, shkenca e gjërave të drejta dhe jo të drejta.

Kush merret me çështje të drejtësisë, duhet të dije prej nga del emri "ius", dhe ajo është qajtur nga drejtësia (iustitia), sepse siç e ka definuar bukur Celsi, drejtësia është mjeshtria e së mirës dhe e së drejtës. Në drejtësi duhet të ketë kujdes për drejtësinë.

IUS ROMANUM

IUS PAPIRIANUM SEUM DE RITU SACRORUM

ROMULUS

Constitutum tunc est ab illo ius patronatus tale: patricos oportebat clientibus cuius ius interpretari, lites pro eis, si iniuria afficerentur, intendere, agentibus adesse; clientes vero oportebat patronos suos iurare in collo-candis filiabus, si parentes opibus carerent, ab hostibus redimere eos, si ipsi aut liberi caputi essent, et tam litium privatarum aestimationes quam publicas multas si condemnati essent, pro eis solvere.

Numa Pomplius

Numa Pomplius statuit eum qui terminum exarasset et ipsum et boves sacros esse.

Negat lex regia mulierum, quae pregnans mortua sit, humari, antequam partus si exciditur; qui contra fecerit, spem animantis cum gravida peremisse videtur.

Tullius Hostilius

Lex lata est propter illum casum iubens, si cui trigemini nasceretur filii, ei de publico alimenta ad pubertatem usque suppeditari.

NGA KODI I JUSTINIANIT

Ulpianus libro primo regularum.

Iustitia est constans et perpetua sunt haec: honeste vivere, alterum non ledere, suum cuique tribuere. Iuris prudentia est divinarum atque humanarum rerum notitia, iusti atque iniusti scientia.

Iuri operam daturum prius nosse operat, unde nomen iuris decendat, est autem a iustitia appellatum: nam ut eleganter Celsus definit, ius est ars boni et aequi. In omnibus quidem maxime tamen in iure aequitas spectanda est.

MITOLOGJIA ROMAKE DHE GREKE

Fjala mitologji vjen nga fjala greke *mithos*-legjendë, *tregim*, dhe *logos* - fjalë, mësim dhe përfshinë tërësinë e gojëdhënave, legjendave për perënditë dhe gjysëmperënditë, për heronjtë e grupeve të caktuara etnike si dhe për fenomenet e ngjarjet e çuditshme dhe për krijesa të mbinatyrshme. Me fjalën mitologji emërohet edhe shkenca që merret me mbledhjen dhe studimin e miteve. Mitologjia ndahet në disa nëndisiplina shkencore, prej të cilave më të rëndësishme janë: kozmogonia dhe teogonia.

Kozmogonia merret me studimin e miteve për krijimin e botës, kurse teogonia merret me mitet, për perënditë, gjysëmperënditë dhe heronjtë.

Romakët dhe grekët besonin në këto perëndi:

Grekët

Romakët

Zeusi	Zoti kryesor	Jupiter
Hera	bashkëshortja e Zeusit - zoti i bashkëshortësisë	Junona
Posejdon	vëllai i Zeusit - Zoti i detrave dhe i burimeve	Neptuni
Had	vëllai i Zeusit - Zoti i nëntokës, dhe i botës së vdekur	Plutoni
Athina	vajza e Zeusit - Zoti i luftërave, dhe i artit, perëndive	Minerva
Apolloni	djali i Zeusit - Zoti i diellit dhe i dritës	
Afërdita	mbretëresha e bimëve, bukurisë dhe dashurisë	Venera
Hefaistosi	djali i Zeusit dhe Herës - zoti i farkatarëve dhe atyre që merren me metalet	Vulkani
Dionizi	djali i Zeusit dhe i Sinelës - Zoti i verës dhe i vreshtarive	Bacchus
Demeter	zoti i drithërave	Ceresi
Hestia	motra e Zeusit - zoti i zjarrit	Vesta
Aresi	zoti i betejave dhe i erërave	Marsi
Artemida	motra e Apollit - zoti i gjuetisë	Diana

Heronjtë më të njohur grekë (gjysmëzotra):

Edipi i cili vrau Sfingën

Perzej i cili vrau Meduzën

Tezej i cili vrau Minotaurën

Më i fuqishmi llogaritet **Herkuli** etj.

KALENDARI ROMAK

Kalendari në fillim të romakët ka qenë mujorë, është ndarë në dymbëdhjetë muaj sipas ndërrimeve të hënës. Mirëpo, viti mujor nuk përputhej me atë diellor, por mbetej prapa tij. Që të barazohej me vitin diellor çdo vit të dytë futej nga një muaj i cili quhej mensis intercalaris. Mirëpo kalendari kishte një çrregullim të madh në llogaritje të kohës, prandaj Cezari e detyroi astronomin aleksandrin Sozigenit që të rregulloj kalendarin sipas viti diellor. Pra, prej asaj kohe viti numëronte 365 ditë. Sipas Cezarit ky kalendar quhej Julian.

Në fillim viti të romakët fillonte më 1 mars, prandaj muaj e tanishëm i nënti (shtatori) quhet September (i shtati), dhe muaji i dhjetë është quajtur Oktomber (i teti), muaji korrik si i pesti, gushti si i gjashti. Mirëpo prej vitit 153 para erës sonë i pari muaj i vitit është janari.

Romakët nuk i numëronin ditët në muaj prej 1 gjer 30 si ne, por brenda muajt i kishin tri ditë të përhershme: kalendae - dita e parë e muajit; Nonae - dita e pestë, e shtatë në mars, në maj, në korrik dhe në tetor; Idus - dita e 13, por e 15 në muajt në të cilat Nonae janë e 7 ditë.

Emrat e tri ditëve të përhershme rrjedhin nga viti i Hënës. Kalendae e shënon hënën e re, Nonae të katërtën e parë, e idus hënën e plotë.

Data e ditëve të përhershme shprehen me rrjedhoren e kohës (ablativus temporis), kurse emmi i muajit figuron si mbiemër.

Kalendis Ianuaris - më 1 janar

Nonis Septembris - më 5 shtator

Idibus Martis - më 15 mars

Ndërsa një ditë para ditës së përhershme është shprehur me pridie:

Pridie Nonas Apriles - më 4 prill

Kurse ditët tjera janë caktuar duke numëruar prapa prej datës së përhershme: ante diem XVI (sextum decimum) kalendas Februaris ose Shkurt a.d.XVI.Kal.Febr.

Zbritja e datës bëhet duke u shtuar Novem dhe ideve nga një ditë, të zbriten ditët e llogaritura, përkatësisht $5 + 1$ dhe $13 + 1$ ose $7 + 1$ dhe $15 + 1$.

a.d.VI. id. Ian. = $(13 + 1) - 6 = 8$ janar

a.d.XVI kal. lun. = $(13 + 2) - 16 = 17$ maj

a.d.VI. Non. Mai. = $(7 + 1) - 6 = 2$ maj

a.d.X. Kal. Oct. = $(30 + 2) - 10 = 22$ shtator

Romakët vitet në fillim i shënonin me emrat e konsujve, të cilët atë vit kryenin detyrën e konsullit. Emrat e tyre shkruhen në rrjedhore (ablativus temporis).

<i>Ditët sipas kalendarit tonë</i>	<i>mars, maj, korrik tetor 31 ditë</i>	<i>janar, gusht, dhjetor 31 ditë</i>	<i>prill, qershor, shtator, nëntor 30 ditë</i>	<i>shkurt 28 ose 29 ditë</i>
1	kalendae	kalendae	kalendae	kalendae
2	VI	IV	IV	IV
3	V	III ante Nonas	III ante Nonas	III ante Nonas
4	IV ante Nonas	Pridie Nonas	Pridie Nonas	Pridie Nonas
5	III	Nonae	Nonae	Nonae
6	Pridie Nonas	VIII	VIII	VIII
7	Nonae	VII	VII	VII
8	VIII	VI ante Idus	VI ante Idus	VI
9	VII	V	V	V ante Idus
10	VI ante Idus	IV	IV	IV
11	V	III	III	III
12	IV	Pridie Idus	Pridie Idus	Pridie Idus
13	III	Idus	Idus	Idus
14	Pridie Idus	XIX	XVIII	XVI
15	Idus	XVIII	XVII	XV
16	XVII	XVII	XVI	XIV
17	XVI	XVI	XV	XIII
18	XV	XV	XIV	XII
19	XIV	XIV	XIII	XI
20	XIII	XIII	XII	X
21	XII	XII	XI	IX ante
22	XI ante	XI ante	X ante	VII
23	X kalendas	X kalendas	IX kalendas	VI
24	IX	IX	VIII	V
25	VIII	VIII	VII	IV
26	VII	VII	VI	VIII
27	VI	VI	V	III
28	V	V	IV	Pridie
29	IV	IV	III	Kalendas
30	III	III	Pridie kalendas	Martias
31	Pridie kalendas Apriles, Iunias August, Novembres	Pridie kalendas Febr. Septemb. Ianuar		Malas. Iul Octob., Decemb

METRIKA

Kjo disiplinë shkencore të romakët është marrë prej grekëve. Pra, romakët gati shumicën e vargjeve e kanë model nga grekët. Kjo disiplinë merret me matjen e vargut.

Rrokjet e bashkuara në një tërësi metrike e përbëjnë këmbën (pes). Shumë këmbë të bashkuara në një tërësi ritmike e përbëjnë vargun (versus). Shumica e vargjeve të përbërë nga dy këmbë e përbëjnë metrin (metrum). Pra gjithashtu sipas kësaj fjale është marrë për shkencë e cila na njofton me përbërjen e vargut, emërtimi - metrika.

Njësia më e vogël e një rrokje quhet mora. Secila këmbë përbëret nga dy pjesë; dallohet më fort - për nga zëri dhe quhet arzë (arsis, ngritje e zërit), e tjetra më e dobët dhe quhet tezë (thesis, ulje e zërit). Arza shënohet me shenjën ' , e cila quhet ictus (goditje), psh. carmina = ∪ ∪ ku car- është arzë e - mina teza. Goditja (ictus) e arzës nuk përputhet gjithmonë me theksin e fjalës.

Këmbët më të zakonshme janë:

<i>diktit</i>	$\angle \cup \cup$
<i>spondej</i>	$\angle _$
<i>trohej</i>	$\angle \cup$
<i>jamb</i>	$\cup \angle$
<i>anapest</i>	$\cup \cup \angle$

Maria: Salve, Clemens! Quid tu feriis egisti?
Clemens: Nave Graeciam² petivi. Complures insulas Graecas spectavi.
Alexandra: Ego quoque in Graecia fui.
Clemens: Quid tibi maxime placuit³, Alexandra?
Alexandra: Mare mihi maxime placuit. Et tu Maria, quid tu egisti?
Maria: Amica, quae in Britannia⁴ habitat⁵, mihi Londinium⁶, maximam illius terrae urbem, monstravit⁷.
Marcus: Salvete! Quomodo valetis?
Omnes: Bene, gratias agimus!
Victoria: Salve, Marce! Dic nobis: Ubi fuisti? Quid egisti?
Marcus: Cum fratre et amico birota⁸ in ripa Danuvii vectus⁹ sum¹⁰. Multa vidimus, multa toleravimus.
Victoria: Ego quoque multa narrare¹¹ possum. Cum parentibus in Italia fui. In tentorio¹² dormivimus¹³.



- ¹ **feriae**, - arum f. - ditë pushimi
² **Graecia**, - ae f. - Greqia
³ **placeo**, es, - ere, - ui - pëlqej
⁴ **Britannia**, -ae f.: - Britania, Anglia
⁵ **habito**, as, - are,, - avi: - banoj
⁶ **Londinium**, - i n.: - Londra
⁷ **nonstro**, - as, - are, - avi, - atum:
 - tregoj
⁸ **birota**, - ae f.: - bineq, bliznak,
 (polyrotësh)
⁹ **Danuvius**, - i m.: - Danubi
¹⁰ **vehor**, - as, - avi, - atum: -mbart,
 transportoj
¹¹ **narro**, - as, - are, - avi, - atum: - tregoj
¹² **tentorium**, - i n.: çadër, shatore
¹³ **dormio**, - is, - ire, - ivi: me flejtur, fjetje.

VOCABULARIUM

Përkthe fjalët:

maximal
 tolerant
 Navigation
 Dictat

Terrarum.
 Egoist
 audiovisuell.
 campus.

EXERCITATIONES PENSUM

1. *Feriae*¹ *magnificae*² fuerunt!

Quid discipuli fecerunt?

Clemens

Alexandra

Marcus

Victoria

Maria

2. *Quem locum discipuli petiverunt? Ubi discipuli fuerunt? Graecia - Britannia - insulae - Italia - ripa Danuvii*³.

Alexandra Graeciam petivit. Alexandra in Graecia fuit.

Maria.....

Clemens.....

Marcus.....

Victoria.....

3. *Quid discipulis maxime placet?*

Clementi⁶ insulas Graecas pete.....maxime placet.

Alexandrae apud mare.....maxime placet.

Marco birota⁷.....⁸ maxime placet.

Victoriae in tentorio⁹.....¹⁰ maxime placet.

Mariae Londinium¹¹ spect.... maxime placet.

4. *Trego ku i keni kaluar pushimet verore?*

.....
.....
.....
.....

Memoria tenete!

Qui bene amat, bene castigat.

Bis dat qui dat celerite.

Bis vincit, qui se vincit.

Perëndit te romakët

Romakët kanë besuar në shumë zotra. Mendohet se numri i tyre ishte shumë i madhë, mbi tridhjetë mijë. Besohet se vetë te fëmijët e posalindur kishin mbi tre perëndi. Kështu fëmija i pa lindur kishte zotin Kunina, posa i linduri Statulin dhe fëmija posa fillonte të ecë kishte Abeonin dhe Adeonën.

1. **feria**, - arum f. Pl.: pushim

2. **magnificus**, - a, -um: madhështor.: shkëlqyeshëm

3. **Danuvius**, -i m.: Danubi

4. **post** - mbas, pas

5. **narro**, - as, - are: tregoj

6. **Clemens**, **Clementis** m.: Fëmijët

7. **birota**, - ae f.: bineq, bliznak

8. **vehor**, **veheris**, **vehi**: mbart, transportoj

9. **tentorium**, - i n.: çadër, shatore

10. **dormio**, -is, -ire: me fjetur

11. **Londinium**, -i n. : Londra

Aleksander: Salve, Cornelia! Quid tu feriis² egisti?
Ubi fuisti?

Cornelia: Cum parentibus in Africa fui. In mari
natavimus³, urbem Carthaginem⁴ vidimus.

Clemens: Suntne moenia urbis Carthaginiis magna?

Cornelia: Certe vidi reliquias⁵ magnificas⁶. Sed urbs
Carthago a Romanis deleta⁷ est.

Victoria: Hannibalem⁸ summum imperatorem
Carthaginiensium⁹ fuisse audivimus.

Anna: Quis autem illum urbem condidit?¹⁰

Cornelia: Rex Tyri¹¹ filium et filiam heredes¹² instituit.
Sed populus filium regem delegisse dicitur.
Filia autem, cui nomen erat Elissa, ab
Acherba¹³ in matrimonium¹⁴ ducta est. Huic
magna copia auri¹⁵ erat, quam metu regis
adductus occultaverat. Ille autem in animo
habuit eius divitias¹⁶ tollere. Itaque Acherbam
occidit. Elissa, ubi facinus fratris animadvertit,
fugere constituit.

¹ **Elissa**, -ae f. Elissa

² **feriae**, arum f. Pl. - pushim

³ **nato**, as, -are, -avi - notoj

⁴ **Carthago**, **Carthaginiis** - Kartagjena

⁵ **reliquiae**, -arum f. (P) - lë, lë pas

⁶ **magnificus**, -a, -um - madhëshor, i
shkëlqyeshëm

⁷ **deleo**, -es, ere, delevi, -etum - asgjësoj

⁸ **Hannibal**, **Hanibalis** m. - Hanibali

⁹ **Carthaginienses**, **Carthaginiensium** m. -
Kartagjenas

¹⁰ **condo**, -is, -ere, condidi, -ditum: -
ndërtoj, thërmoj

¹¹ **Tyrius**, -i f: -Tiri, qytet bregdetar i
Fenikasve

¹² **heredes instituere** (instituit perfect):

¹³ **Acherba**, -ae m.: -Akerba

¹⁴ **in matrimonium ducere**: -çfaqet në
martesë, dasëm

¹⁵ **aurum**, -i m.: flori

¹⁶ **divitiae**, -arum f. Pl. - pasuri, begati



VOCABULARIUM

Përkthe fjalët nga shqipja në latinisht:

Pushim

Detë

Malë

Kodër

Pasuri

Varfëri

Martesë

Kohë

EXERCITATIONES PENSUM

1. Përgjigju latinisht:

Quis fuit Elissa?
Quis eam iu matrimonium¹ duxit?
Qid fecit frater eius, ubi rex factus est?
A quo urbs Carthago² deleta³ est

2. Plotëso fjalitë me përemrat:

Cornelia,.....cum parentibus in Africa fuit,
etiam urbem Cartheginem vidit
Regis filia..... nomen erat Elissa⁴ ex
urbe fugit.
Rex novus aurum⁵,..... Acherba⁶
occultaverat, tollere in animo habuit.
Frater Elissae Acherbam occidit,
magna copia auri erat.
Elissa..... facinus fratris
animadverberat, fugere constituit.

3. Përshtati fjalitë: Activum - passivum:

Populus filium regis delegit - Filius regis a
populo delectus est
Acherba⁶ Elissam⁴ in matrimonium duxit,.....
Acherba aurum⁵ occultaverat.....
Rex novus Acherbam occidit.....
Clemens complures insulas spectavit.....
Consul signa rerum futurarum⁷ neglexit.....

4. Vendosi shprehjet në rasën emërore njëjës:

Copiam, huic, filium, fratris, animo, Romanis, rege,
nomine, urbium, insulas metu.

5. Përkthe fjalët:

facinus locorum.....
navibus..... regem
urbis..... terras
virgini..... viros
castra..... dis
igne..... agminis

Memoria tenete!

Memoria tenete!
Qui vos vincunt, aquam bibunt.
Qui bene distinguit, bene docet.
Dura lex sed lex,

Komedia

*Romakët kishin të zhvilluar komedin
mimike, të cilën e shfaqnin nëpër rrugë
pa maska. Në komedi mund të merrnin
pjesë edhe gratë që të luanin ndonjë rol.
Por suksesi i tyre nuk ishte sa:
meshukjve vendi ku mbaheshin
komeditë ishte i hapur i ndërtuar prej
gurësh të ndërtuar në formë amfiteatri.*

¹ **matrimonium**, -i n. : martesë

² **Carthago, Carthaginis**. f. : Kartagjena

³ **deleo**, - es, - ere, delevi, - etum: asgjësoj,
çfaros

⁴ **Elissa**, - ae, f.: Elisa

⁵ **aurum**, - i n. : flori, ari

⁶ **Acherba**, - ae m. : Akeba

⁷ **res futurae** f. Pl.: gjë e ardhme, sendi i
ardhshëm

Cornelia: Elissa, ubi maritum³ a fratre occisum esse animadvertit, fugere constituit. Alii quoque, qui regem novum timebant, cum ea Africam petiverunt. Ibi emit⁴ locum, qui corio⁵ tauri⁶ tegi⁷ potuit. In animo enim habuit urbem novam condere.

Felix: Potuitne urbem in illo loco parvo condere?

Cornelia: Elissa mulier prudentissima fuisse videtur. Corium in tenuissimas⁸ partes secari⁹ iussit atque ita maius loci spatium¹⁰ occupavit, quam petiverat. Ita urbs Carthago¹¹ condita fuit. Postea imperium Carthaginiensium¹² magnum fuit.

¹ **Elissa**, - ae f.: Elisa

² **condo**, -is, ere, condidi, - ditum: - ndërtoj, themeloj

³ **maritus**, -i m.: - burrë, bashkëshort

⁴ **emo**, -is, ere, emi: blej

⁵ **corium**, -i n.: lëkurë, ryp.

⁶ **taurus**, -i m.: - dem, mëzat

⁷ **tego**, -is, -ere: mbyll sytë, fsheh

⁸ **tenuis, tenue**: - hollë, i ngushtë

⁹ **seco**, - as, are, avi, atum: - këpus, pres

¹⁰ **spatium**, -i n.: - hapësirë, shtrirje

¹¹ **Carthago, Carthaginiis** f.: - Kartagjenë

¹² **Carthaginienses, Carthaginiensium** m. Pl. - Kartagjenasit



VOCABULARIUM

Përkthe fjalët nga shqipja në latinisht:

Lokalitet

Lundrim

Kundërshtar

i madh

Okupim

Përshtatje

Mjeshtër

Ushtarë

EXERCITATIONES PENSUM

1. Përgjigju latinisht

Quam terram Elissa¹ cum aliis fugientibus petivit?
Quomodo locum maximum emit²?
Quod nomen urbi novae datum est?
De quo imperatore illius populi iam audivisti?

2. Elissa de vita sua narat.³

3. Përkthe shprehjet (foljet) dhe ndrysho kohët e tyre?

ago, peto, specto, sum, dico, tolero, video, audio,
facio, fugio, deligo, duco, occulto, habeo, tollo,
adduco, occido, animadverto, constituo, timeo,
possum, occupo.

4. Përkthe fjalitë dhe trego kush janë foljet:

Elissa fratrem fugiens Africam petivit.
Elissa aliis de marito⁴ occiso narravit³.
Frater Elissae aurum⁵ bene occultatum tollere in
animo habuit.
Elissa locum emens² prudentissima videbatur.
Homines novum regem timentes in Africam
fugerunt.

Memoria tenete!

In vito veritas.

Pro rege saepe propatria semper.

Panem et circenses.

Festat

Romakët për hirë të festave, të cilat ishin shumë, organizonin gara të ndryshme, por më të preferuara ishin vrapimi me kuaj dhe këndim i këngëve të ndryshme.

¹ **Elissa**, - ae, f. : Elisa

² **emo**, - is, - ere, emi: blej

³ **narro**, -as, - are, - avi, - atum: tregoj

⁴ **maritus**, -im: burrë, bashkëshort

⁵ **aurum**, -i n. : arë, flori

Equus Alexandri signum capitis taurini¹ impresum² habuisse dicitur. *Qua de causa* Bucephalas³ appellatus est
 Hic, cum regio⁴ ornatu⁵ instratus⁶ erat, Alexandrum solum recepit in sedem⁷.
 Quondam⁸ in proelio graviter vulneratus est. Qua re animadversa rex in alium equum transire⁹ in animo habuit, Bucephalas autem id passus¹⁰ non est.
 Multa alia eius *modi* fecisse dicitur. Equo interfecto Alexander funus magnificum¹¹ paravit¹² urbemque in eo loco condidit¹³ nomine eius.

- ¹ **caput taurinum** n. - koka e demit, kryet e demit
² **imprimo**, -is, ere, impressi, -pressum - ndrydh, shtyp, vë vulë
³ **Bucephalas**, ae m. Buqefal, emër i kalit të Lekës
⁴ **regius**, a, -um: - mbretërorë, pushtet mbretëror
⁵ **ornatus**, ornatus m:
⁶ **instratus**, -a, -um: - zbukurim, stoli
⁷ **sedes**, sedis f: - fron, karige
⁸ **quondam**: njëherë, dikurë
⁹ **transeo**, -is, -ire - kaloj, ia kaloj
¹⁰ **passus** est - hap, çap
¹¹ **magnificus**, -a, um: madhështor, i shkëlqyeshëm
¹² **paro**, as, are, avi, atum.- pregatis, organizoj



VOCABULARIUM

qui, quae, quod - / cili? që, e cila? çfarë?
causa, - ae, f. - shkak
qua de causa - ndonjë shkak, çfar shkaku
modus, -i, m. - masë, kufi mase

ARS GRAMMATICA

Ablativus absolutus. Rrjedhorja e lirë.

Equo interfecto Alexander funus paravit.

Me rrjedhoren latine mund të zëvendësohen këto fjali të varura: kohore, shkakore lejore dhe kushtore: P.sh. në fjalinë *Equo interfecto Alexander funus paravit*, zëvendëson fjalinë kushtore.

Në gjuhën shqipe rrjedhorja absolute mund ta përkthejnë edhe me fjali të varur, kryefjalën nuk e gjejmë në fjalinë kryesore në asnjë rasë.

EXERCITATIONES PENSUM

1. Defino shprehjet që ndodhen në ablativus absolutus (rrjedhore të lirë) dhe përkthe ato:

Minotauro occiso Theseus cum liberis et Ariadna navem ascendit?¹

Iniuria a Tarentinis² accepta Romani bellum acerrimum gesserunt.

Ariadna in insula relicta Theseus domum venit.

Elephantis Pyrrhi regis visis milites fugere coeperunt.

Pelope³ interfecto Tantalus in Tartarum⁴ missus est.

Troi superata Graeci domum redire in animo habuerunt.

Polyphemo vulnerato Ulixes cum comitibus fugit.

Aliis Cyclopibus convocatis Polyphemus auxilium petivit.

Tarquinus pretio⁵ audito mulierem delirare⁶ putavit.

Tribus libris in ignem coniectis mulier regi reliquos eodem pretio obtulit.

Sole repente obscurato⁷ summus metus animos Atheniensium⁸ occupavit.

Comitibus a Circe mutatis⁹ Eurylochus¹⁰ ad Ulixem rediit.

Remedio¹¹ a Mercurio accepto Ulixes comites liberavit.

Columbis¹² missis consul Brutum certiozem fecit.

Achille occultato Ulixes ad Lycomedem venit.

Clade¹³ maxima in Germania accepta Augustus dicere solebat: "Vare, Vare, redde legiones!"

Artemisia viro amisco magnificentum¹⁴ sepulcrum¹⁵ fecit.

Magnus erat metus Atheniensium⁸ luna¹⁶ solem obscurante.

Memoria tenete!

O, tempora! O, mores!

Mors ultima ratio.

Sutor, ne supra crepidam.

Ndërtimtaria te romakët.

Romakët kanë qenë ndërtues të mirë të ndërtesave të ndryshme, ato adaptonin stilin grek. Po ashtu ato adaptonin edhe ndërtimin e limaneve, urave, ujësjellsit dhe amfiteatreve të huazuar nga mesopotamia. Në shekullin e II para erës sonë romakët zbuluan çimenton, kështu u lehtësua shumë ndërtimi i ndërtesave të mëdhaja siç është Panteoni në Romë.

¹ **ascendo**, -is, ere, ascendi: hypi, ngjitem

² **Tarentini**, -orum m. Pl.: Tarentët (qytet në brigjet e Greqisë)

³ **Pelops**, Pelopis m.: Pelopa

⁴ **Tartarus**, -i n.: Tartar

⁵ **pretium**, -i n. çmim, vleftë

⁶ **deliro**, -as, -are: dredhoj

⁷ **obscurus**, -as, -are, -ari, -atum: lus, lutem

⁸ **Athenienses**, Atheniensium m. Pl.

Rrjedhorja e ndarjes shpreh vendin nga nis veprimi ose objekti nga ndahemi a shkëputim marrëdhëniet. Në kuptimin e parë, rrjedhorja gjendet pas foljesh që shprehin lëvizje, kurse rrjedhorja mund të jetë:

- a) një emër qyteti ose i një ishulli të vogël:
Proficisci Roma, Athinis, Corintho, Delphis, Rodo.
Nisem nga Roma, Athina, Korintheta, Delfi, Rodo.
- b) emrat domus ose rus:
Domo/rus venio.
Vij nga shtëpia / fshati.

Rrjedhorja e kohës (ablativus temporis)

Rrjedhorja në latinisht mund të shprehë edhe kohën kur realizohet veprimi. Një rrjedhore e tillë jepet:

- a) me emrat që emërtojnë kohë ose fragmente kohore, si:
tempus (kohë), aetas (stinë), ver (pranverë), hiems (dimër),
dies (ditë).
nox (natë), mensis (muaj), annus (vit), hora (stinë) etj.
- b) me emrat: initium (fillim), adventus (arritje), itus (dalje) etj.
- c) emrat e festave, të lojërave, të mbledhjeve:
Hieme fumina rara sunt.
Në dimër rrufetë janë të rralla.

Caesar tertia vigilia projectus est.
Cezari u nis në rojën e tretë të natës.

Kallëzorja me paskajoren (accusativus cum infinitivo)

Kallëzorja me paskajoren është një fjali e varur në të cilën kryefjala gjendet në kallëzore, e folja kthehet në paskajore. Kjo fjali e varur përdoret në gjuhën latine. Kur në fjalinë e pavarur gjendet:

- a) një folje dicendi, sentiendi, voluntatis apo një folje affectuum;
- b) njëra nga foljet iubeo (urdhëroj), veto (ndaloj), sino (lejoj), patior (duroj) etj.
- c) në njësi sintaksore e formuar prej një mbiemri asnjëanës ose një emri bashkë me foljen esse.

Foljet dicendi dhe sentiendi tregojnë gjendjen shpirtërore të njeriut dhe të të folurit.

Gjinorja kryefjalore dhe gjinorja kundrinore (genetivus subjectivus et objectivus).

Amor parentum liberos oblectat.

Dashuria e prindërve i gëzon fëmijët.

Amor parentum liberis inniatus est.

Dashuria për prindërit fëmijët e kan që nga lindja.

Në fjalinë e parë amor parentum shënon dashurinë që vjen nga prindërit. Kur emri amor zëvendësohet me foljen amare, emri në gjinore bëhet subjekt i kësaj foljeje: Parentes amant. Për këtë arsye gjinore të tilla quhen kryefjalore (subjectivus).

Në fjalinë e dytë amor parentum do të thotë dashuria për prindërit. Ata janë objekt i kësaj dashurie, prandaj po të zëvendësohet emri amor me foljen amare, emri në gjinore do të kthehet në kundrinor të drejtë: parentes amamus. Për këtë arsye gjinorja parentum quhet kundrinore (objectivus)

Në latinisht mund të ndodh që i njejtë emër, të marrë dy gjinore, nga të cilat njëra është subjektore, tjetra objektore:

Hanibalis odium Romanorum.

Urrejtja e Hanibalit për romakët.

Gjinorja e cilësisë (genetivus qualitatis)

Gjinorja që tregon se çfarë është personi ose sendi quhet gjinore e cilësisë ose qualitatis. Një gjinore e tillë ka gjithmonë pranë vetës një përcaktor. E përkthejmë rëndom vetëm me gjinore, kurse nganjëherë me rrjedhoren me parafjalën: prej ose me.

Seneca vir excellentis ingenii erat.

Seneka ishte burrë me mençuri të shkëlqyer ose i shquar për nga mençuria.

Gjinorja e cilësisë shënon cilësinë, numrin, çmimin, vlerën, moshën, llojin dhe mënyrën.

miles magnae fortitudinis.

ushtar me fuqi të madhe.

exsilium decem annorum
 mërgim dhjetëvjeçarë.
 Pericules, spectatae virtutis vir, dux electus est.
 Perikliu, burrë me virtute të njohura, u zgjodh kryekomandant.

Verba reflectiva

Fio, fierre, factus sum - bëhem, dal, ndodh

<i>Dëftorja - indicativus</i>	Lidhorja - coniunctivus
E tashmja: fio, fis, fit, fiunt	fiam, fias, fiat
E pakryera: fiebam, fiebas, etj.	fiamus, fiatis, fiant
E ardhmja: fiam, fies etj.	fierem, fieres etj

<i>Paskajorja</i> e së tashmes: e së kryerës: e së ardhmes:	fieri factum, -am, -um esse futurum, -am, -um esse ose: fore
Gjerundivi:	faciendus, -a, -um

Folja fio shërben për trajtat pësore të foljes facio, 3. feci, factum - bëj, kryej, përkrah formimin e trajtave kjo folje bën pjesë në verba semideponentia.

Foljet mungesore - verba defectiva

coepi, coepisse kam filluar (fillova).
 memini, meminisse më kujtohet
 odi, odisse urrej

Folja memini dhe odi nuk i kanë trajtat e temës të së tashmes, dhe për këtë u shërben e kryera me kuptimin e së tashmes (perfectum praesens), e kryera e plotë me kuptimin e së pakryerës, kurse e ardhmja e përparme me kuptimin e së ardhmës.

Folja coepi ka kuptimin e së kryerës, kurse trajtat e temës të së tashmes i merr prej foljes incipio 3. filloj, nis

Dëftorja e së kryerës (indicat perf.)	coepi	memini	odi
Lidhorja e së kryerës (coniu perf.)	coeperim	meminerim	oderim
Dëftorja e së kryerës (indicat plusq.)	coeperam	memineram	oderam
Lidhorja e së kryerës (coniu plusc)	coepissem	meminissem	odissem
E ardhmja (Futurum II)	coepero	meminero	odero
Urdhërorja (imperativus)	- -	memento mementote	-
Paskajorja e së kryerës (Inf. perf.)	coepisse	meminisse	odisse
Pjesorja e së kryerës pës. (Part. perf. pas)	coeptus, a,um	-	
Pjesorja e ardh. vep. (Part. fut. act.)	coepturus, a, um	-	osurus -a,um

Foljet njëvetore - Verba impersonalia

Foljet njëvetore përdoren vetëm në vetën e 3-të, njëjës dhe në paskajore.

Ndahen në dy lloje: të vërteta dhe të prejardhura. Të vërteta janë ato folje që përdoren vetëm në një vetë, kurse të prejardhura janë ato që vijnë prej foljeve të cilat përdoren edhe në veta tjera por me kuptim të ndryshëm.

Të vërteta janë:	Të prejardhura janë:
decet, 2. decuit ka hije, shkon dedecet, 2. dedecuit nuk ka hije, nuk shkon licet, 2. licuit ose licitum est lejohet, ka mundësi. oportet, 2. oportuit duhet me 2. oportuit më vjen turp paenit et me, 2. paenituit, pendohem	iuvat me, 1. iuvit më pëlqen: krahaso iuvo, 1. iuvi, iutum ndihmoj apparet, 2. apparuit duket, duket qartë; krahaso appareo, 2. apparui - dukem, shfaqem pudetconstat. 1. constitit dihet, është ditur praestat, 1. praestitit më mirë është

Foljet deponente dhe gjysmëdeponente - verba deponentia et semideponentia

Foljet që kanë humbur diatezën veprorë dhe kanë ruajtur vetëm pësoren me kuptim vepror, në gjuhën latine quhen folje deponente. Kurse foljet gjysëmdeponente janë ato që në kohën e tashme, në të pakryerën dhe në të ardhmen kanë ruajtur vetëm diatezën veprorë, kurse në të kryerën, në të kryerën e plotë dhe në të ardhmën e përparme kanë vetëm trajta të diatezës pësore me kuptimin vepror.

Folje deponente janë:

hortor, 1 - qortoj; nxit
vereor, 2 - kam frikë
loquor, 3 - flas
largior, 4 - jap

Folje gjysmëdeponente janë:

audeo, 2 ausus sum - guxoj
gaudeo, 2 gavisus sum - gëzohem
fido, 3 fissus sum - kam besim, besoj
soleo, 2 solitus sum - (e) kam shprehi

Foljet deponente dhe gjysmëdeponente në të gjitha kohët dhe mënyrat zgjedhohen si foljet e tjera të rregullta të diatezës pësore, pos gjysmëdeponenteve, që i kanë të tri kohët e formuara nga tema e së tashmes.

Emrat prejfoljorë të tyre ruajnë trajtën dhe kuptimin e foljeve veprorë. Kështu foljet deponente kanë ruajtur format e diatezës veprorë të pjesores të së tashmes (hortans), të pjesores së ardhme (hortaturus,a,um), të supinit (hortatum) dhe të gjerundivit (hortandi).

Gjithmon në mungesë të trajtës dhe diatezës veprorë, foljet deponente jepen në vetën e parë të së tashmes së dëftores pësore dhe në vetën e parë të së kryerës pësore.

moriōr, 4. mortuus sum - vdes
proficiscor, 3. profectum sum - udhëtoj, shkoj
nascor. 3. natus, sum - lind
utor, 3 usus sum - përdor
sequor, 3. sectus sum - ndjek, përcjell
obliviscor, 3. oblitus sum - harroj

Zgjedhim i foljes: hortor, 1 (hortari), hortatus sum

Mënyra dëftore

Koha e tashme		Koha e pakryer	
I hortor	- hortamur	I hortabar	- hortabamur
II hortaris	- hortamini	II hortabaris	- hortabamini
III hortatur	- hortantur	III hortabatur	- hortabantur

Koha e ardhme

I hortabor - hortabimur
II hortaberis - hortabimi
III hortabitur - hortabuntur

Mënyra urdhërore

I	II
II Sg. hortare	II. Sg hortator
II. Pl. hortamini	III Sg. hortator
	II Pl. hortabimini
	III Pl. hortantur

Koha e kryer

I	hortatus, sum	I	hortati sumus
II	a,um es	II	ae, a estis
III	est	III	sunt

Koha e kryer e plotë

I	hortatus, eram	I	hortati, eramus
II	a, um eras	II	ae, a eratis
III	erat	III	erant

Koha e ardhme e përparme

I	hortatus, ero	I	hortatis, erimus
II	a,um eris	II	ae, a eritis
III	erit	III	erunt

<i>Paskajorja e së tashmes:</i>	hortari
<i>Paskajorja e së kryerës:</i>	hortatum esse
<i>Paskajorja e së ardhmës:</i>	hortaturum esse

<i>Pjesorja e së tashmes:</i>	hortans, hortantis
	supini
	hortatum
	hortatu

Lakimi i emrave grekë

Në gjuhën latine ka hyrë një sasi emrash prej gjuhës greke. Një pjesë e tyre është latinizuar plotësisht, d.m.th. gjatë lakimit ka marrë fundoret latine, kurse pjesa tjetër, në numrin njëjës, ka ruajtur disa trajta nga gjuha greke.

Emrat e huazuar nga gjuha greke lakohen sipas lakimeve të latinishtes (I, II, III) por me pak ndryshime.

Lakimi i parë i emrave grekë.

Në këtë lakim hyjnë emrat e përveçëm dhe të përgjithshëm të gjinisë mashkullore që në Nom. Sing. kanë fundoret -es dhe -as si dhe emrat e përveçëm dhe të përgjithshëm femërorë që në Nom. Sing. kanë fundoren -e.

Psh.

Aeneas, -ae, m - Eneu	Circe, - es. f. - Circe
Boreas, -ae, m - Veriu	Niobe, -es. f - Nioba
Pythagoras, ae, m - Pitagora	Melpomene. -es. f - Melpomena
Epaminondas, -ae, m - Epaminonda	Danae, -es, f - Danaja
Leonidas, -ae, m - Leonidha	epitome, -es, f - përmbledhje
Orestes, ae, m - Oresti	gramatice, -es, f - gramatikë
Anchiles, -ae, m - Ankizi	musice, -es. f- muzikë
Sophistes, -ae, m - Sofist	anagnostes, -ae, m - lexues.

Shembuj lakimi

	Sing.	
	m	f.
Nom.	Aeneas	Circe
Gen.	Aeneae	Circes
Dat.	Aeneae	Circae
Acc.	Aeneam (an)	Circen
Abl.	Aenea	Circe
Voc.	Aenea	Circe

Shënim: Në shumës vlejné mbaresat e lakimit të parë të latinishtes.

Lakimi i dytë i emrave grekë

Ky takim përfshinë emrat grekë (zakonisht të përveçëm) të gjinisë mashkullore dhe femërore që në Nom. Sing. mbarojnë me -us, dhe -os si dhe emrat e gjinisë asnjëanëse që në Nom. Sing. dolin me -on.

P.sh.

Orpheus, -i, m	- Orfen
Delos, -i, f	- Deli
Peleus, -i, m	- Pelen
Cypros, -i, f.	- Qipro
Theseus, -i, m	- Tezeu
Ilion, -i, n	- Ilioni
Prometheus, -i.m.	- Prometeu

Shembuj lakimi

	Sing.		
	m	f.	n.
Nom.	Orpheus	- Delos	- Ilion
Gen.	Orohei (Orpheos)	- Deli	- Ilii
Dat.	Orpheo	- Delo	- Illo
Acc.	Orpheum (on)	- Delon	- Ilion
Abl.	Orpheo	- Delo	- Illo
Voc.	Orpheu	- Dele	- Ilion

Shënim: Në shumës vlejné mbaresat e lakimit të dytë të latinistes të gjinisë mashkullore (m.f.) dhe të gjinisë asnjëanëse.

Lakimi i tretë i emrave grekë.

Në këtë lakim bëjnë pjesë emrat parisilabë të gjinisë femërore që në Nom. Gen. Sing. kanë fundoren -is si dhe emrat e përveçëm mashkullore parisilabë që në Nom. Sing. dalin me -es.

Psh.

poesis, poesis, f.	- poezi
dosis, dosis, f.	- dozë
Socrates, is, m.	- Sokrati
Achilles, is, m.	- Akileu

Shembuj lakimi

Sing.

	m.	f.	
Nom.	Achilles		- poesis
Gen.	Achillis, Achilli		- poesis dhe poeseos
Dot.	Achilli		- poesi
Acc.	Achillem, Achillen (ea)		- poesim, poesin
Abl.	Achille		- poesi
Voc.	Achilles, Achille		- poesis

Shënim: Shumësi lakohet me mbaresat e lakimit të tretë me karakter bashkëtingëllorë.

SINTAKSA E RASAVE

Rasa kallëzore - casus accusativus

Rasa kallëzore sipas kuptimit të vet themelor tregon objektin ku bie e drejtohet veprimi foljor. Rasa kallëzore në latinisht nga kuptimi i saj themelor përkon me kallëzoren e shqipes, ajo është rasë e kundrinorit të drejtë.

Filia rosas amat. E bija pëlqen trëndafilat.

Kallëzorja del edhe me kuptime të tjera, ajo mund të shpreh gjithashtu rrethanë kohore ose rrethanë vendore:

Eo rus. Shkoj në fshat.

Bestiolae, quae unam diem vivunt. Kafshëza që jeton një ditë.

Përdorimi i kallëzores është i lidhur me kuptimin leksiko-gramatikor të foljes (kundrinori i drejtë dhe kallëzorja e hapësirës) ose vetëm me kuptimin leksikor të emrit (kallëzore e kohës). Kallëzorja drejtohet nga foljet. Ato marrin zakonisht një kallëzore, po ka folje që mund të marrin edhe dy kallëzore, të cilat kanë funksione të ndryshme (dy kallëzoret), por në raste të veçanta mund të shprehin të dyja objekte të veprimit.

Foljet doceo (mësoj), educco (edukoj), cedo (fsheh), marrin dy kundrina në kallëzore, nga të cilat njëra shpreh objektin që është personi mbi të cilin ushtrohet veprimi i foljes, dhe tjetra që është send shpreh objektin ku përqëndrohet veprimi i foljes. Në gjuhën shqipe të parit do t'i përgjigjej një kundrinor në dhanore, të dytit një kundrinor në kallëzore:

Doceo te gramaticam. Unë të mësoj gramatikën.

Hanc rem te celavi. Ta fsheha këtë gjë.

Shënim 1. Nëqoftëse sendi me të cilin dikush mësohet, është mjet, përdoret ablativi pa parafjalë.

Doceo aliquem equo. I mësoj dikujt kalin.

Shënim 2. Kur doceo dhe educeo kanë kuptimin "informoj a bëj të ditur", atëherë objekti i informimit jetep me ablativ të prirë nga parafjala de:

Doceo aliquem de aliqua re. Informoj për diçka.

Celo aliquem de aliqua re. E largoj dikë, i heq mundësinë për të mësuar diçka.

Kallëzorja e vendit ose e hapësirës - accusativus loci vel extensivus

Përmasat e sendeve, dmth. gjatësia, lartësia dhe thellësia shprehen me kallëzore, pranë së cilës zënë vend rregullisht, mbiemrat longus, altus. Një kallëzore e tillë quhet kallëzore e vendit ose e hapësirës.

Milites aggerem latum pedes trecentos, altum pedes octaginta exstruxerunt.

Ushtarët e ngritën një ledh të gjërë 300 këmbë të lartë 80 këmbë.

Largësia ndërmjet dy vendeve pranë foljeve distare, abesse (jam larg) shprehet me kallëzore.

Zama quinque dierum iter ab Carthagine abest.

Zama është pesë ditë rrugë larg nga Kartagjena.

Emrat e qyteteve, fjalët domus (shtëpi), rus (fshat) në rasën kallëzore pa parafjalë me foljet që tregojnë lëvizje, shërbejnë si rrethanore vendi, i përgjigjen pyetjes ku? për ku?

Romam redeo. Kthehem në Romë.

Domum venio - Vij në shtëpij.

Në gjuhën latine kjo kallëzore është e detyrueshme. Në poezi përdorimi i kësaj kallëzorje është i lirshëm:

Romam tota Italia convenit. E gjithë Italia shkoi në Romë.

Balbus domum meam venit. Babi erdhi në shtëpinë time

Ego rus ibo atque ibi manebo. Unë do të shkoj në fshat dhe do të qëndroj atje.

Kallëzorja e kohës - accusativus temporis.

Kallëzorja në gjuhën latine mund të shprehë edhe kohën e realizuar të veprimit. Koha mund të shprehet me këtë formë si zgjatje e pandërprerë (accusativus extensivus temporis):

Sollicitari notesque diesque. Shqetësohem natë e ditë.

Bestiolae, quae unum diem vivunt. Kafshëza që jetonë një ditë.

Diem unum supplicatio fit. Festa e lulëve ishte, zgjati një ditë.

Kallëzorja mund të tregojë kohën sa zgjat veprimi i shprehur prej foljes. Në këtë rast emri në kallëzore që emërton fragment kohor shqetësohet me fjalë sasive:

Pugnam est contenter horas quique. U luftua pesë orë pa pushim.

Duodequadraginta annos tyrannus Syracusanorum fuit Dionysius.

Dionisi qe 38 vjet sundimtar i Sirakuzës.

Dy kallëzoret - accusativus duplex

Në latinisht një folje mund të drejtojë dy kallëzore. Njëra kallëzore emër a përemër që emërton person, shpreh objektin e dytë të veprimit, objektin mbi të cilin veprimi nuk bie drejtëpërdrejtë, (kjo kallëzore përkthehet në shqip me dhanore), kurse kallëzorja e dytë, emër që emërton send, shpreh objektin e drejtëpërdrejtë të veprimit të foljes (kjo kallëzore përkthehet me kallëzoren e shqipes). Në latinisht quhet accusativus duplex:

Dionisius Epaminondam musicam docuit.

Dionizi Epaminondes i dha mësim në muzikë.

Livia mortem Augusti omnes aliquandiu celavit.

Livia ua fshehu të gjithëve një kohë vdekjen e Augustit.

Ky lloj kundrinori quhet accusativus persone et rei (kallëzore e personit dhe e sendit). Këto kallëzore gjenden pranë foljesh kalimtare, të tilla si: doceo, edoceo (mësoj):

Doceo aliquem aliquid. I mësoj dikujt diçka.

Catilina inventum mala facionora ed ocebant. Katilina i mësonte rinisë gjëra të mbrapshta.

Foljet: rogo, oro, posco, exposco, flagito, po, stulo (të gjitha me kuptimin, kërkuj, lus.)

Optium divos rogat. U kërkon perëndive prehje:

Verres Milesios navem poposcit. Versi u kërkoi Miletëve anije.

Shënim: Kur doceo ka kuptim "lajmëroj", në vend të kallëzores së sendit gjendet rrjedhorja me parafjalën de,

P.sh.

Caesar senatum de victoria sua docuit. Cezari e lajmëroj senatin për fitoren e vet.

Pranë foljes celo në veprorë, në vend të kallëzores, mund të qëndrojë edhe rrjedhorja me parafjalën de. Kur celo është në pësorë, qëndron vetëm rrjedhorja me parafjalën de.

De morte amici celatus sum. Më kanë fshehur vdekjen e mikut.

Rasa gjinore - casus genitivus

Gjinorja kryefjalore dhe gjinorja kundrinore - genitivus subjectivus et objectivus.

Amor parentum liberos oblectat. Dashuria e prindërve i gëzon fëmijët.

Amor parentum liberis inniatus est. Dashurinë për prindërit fëmijët e kanë që nga lindja.

Në fjalinë e parë amor parentum shënon dashurinë që vjen nga prindërit. Kur emri amor zëvendësohet me foljen amare, emri në gjinore bëhet subjekt i kësaj foljeje: parentes amant. Për këtë arsye gjinore të tilla quhen kryefjalore (subjectivus).

Në fjalinë e dytë amor parentum do të thotë dashuria për prindërit. Ata janë objekt i kësaj dashurie, prandaj, po të zëvendësohej emri amor me foljen amare, emri në gjinore do të kthehej në kundrinor të drejtë: parentes amamus. Për këtë arsye gjinorja parentum quhet kundrinore (objectivus).

Në shembullin: odium Gallorum (urrejtja e galëve) gjinorja mund të jetë edhe subjektore dhe objektore pra ka dy përmbajtje: Galët urrejnë dhe (dikush) i urren galët.

Në latinisht mund të ndodhë që i njejtë emër, të marrë dy gjinore, nga të cilat njëra është subjektore, tjetra objektore: Hanibalis odium Romanorum (Urrejtja e Hanibalit për romakët), ku Hanibalis është subjekt i emrit odium e Romanorum objekt i tij.

Sipas kuptimit të fjalisë, shihet se ka gjinorja kuptim kryefjalor apo kundrinor.

Gjinore kundrinore kemi edhe te këta shembuj.

metus mortis (frika e vdekjes ose nga vdekja) mortem metuere (i trembem vdekjes), spes victoriae (shpresa e fitores ose për fitoren), victoriam sperare (shpresoj të fitoj), desiderium patriae (malli për atëdheun), patriam desiderare (përmallohem për atëdheun), citus litterarum (kultivimi i letërsisë).

Gjinorja kundrinore e përemrave vectorë nos dhe vos është nostri dhe vestri. Kjo gjinore më së shpeshti përkthehet me shprehje parafjalore, psh. timor vestri (frika nga ju).

Kur është fjala për person, gjinorja kundrinore mund të zëvendësohet me parafjalën in, erga, adversus, psh. : odium in tyrannum (urrejtje ndaj tiranit), meus erga fratrem amor (dashuria ime për vëllanë).

Rasa dhanore - casus dativus

Dhanorja e vepruesit - dativus auctoris

Pranë gjerundit, më rrallë pranë pjesores të së kryerës dhe pranë trajtave të formuara me të, në vend të rrjedhores me parafjalën a ose ab, zë vend dativus auctoris, psh.:

Libri tibi legendi sunt. Duhet të lexosh libra.

Hic vobis vincendum aut moriendum est. Këtu duhet të fitoni ose të vdisni.

Cui non sunt audita Demosthenis vigiliae? Kush nuk ka dëgjuar për vigjëlimet e Demosthenit? Te poetët, më rrallë në prozë, kjo dhanore përdoret edhe pranë trajtave të tjera pësore; P.sh.:

Barbarus hic ego sum, quia non intellegor ulli. Këtu jam vetë i huaj për arsye se askush nuk po më kupton.

Aeneas cernitur nullui. Eneun nuk po e vëren askush.

Dhanorja e dobisë - dativus commodi

Non nobis solis nati sumus, sed etiam patriae nostrae. Kemi lindur jo vetëm për ne vetë, por edhe për atdheun tonë.

Non scholae, peccat. Secili gabon për vete.

Kjo dhanore quhet dhanore dobie (dativus commodi), Dhanorja e këtillë gjendet pranë disa foljesh, që mund të ndërtohen edhe me kallëzore pa ose me parafjalë, por në këtë rast kanë një kuptim tjetër:

consulo urbi (kujdesem për qytetin), consulo Apollinem (këshillohem me Apollin), caveo amico (prengosem për mikun), care canem (ruaju prej qenit), caveo ab insidiis (ruhem nga pusia), provideo periculum (kujdesem për shpëtimin tim), timeo, metuo libertati (jam i brengosur për liri), moderor navem (drejtoj anijen), tempero hostibus (kursej armiqtë).

Një rast i veçantë i dhanores pa parafjalë është dhanorja që shpreh personin apo objektin, në dobi të të cilit kryhet apo egzoston diçka dhanorja e dobisë. Ajo u përgjigjet pyetjeve: për kë?, për çfar? në interes të kujt? në dobi të kujt?

Patriae laborare (punoj për vete), sibi legere (lexoj për vete), vitae discere (mësoj për jetë).

Në gjuhën shqipe ky ndërtim jepet me kallëzoren dhe parafjalën për. Rasa dhanore e dobisë tregon objektin, në dobi të të cilit kryhet diçka. Kjo dhanore shërben si kundrinor i drejt nga këto folje: studeo (merrem me diçka), studui (përpiqem, bind), parco, peperci (kursej), nubo, nuppsi, persuasum (mbush mendjen, bind), medeor (mjekoj), meledico, meledixi, meledictum (flas keq, shaj),

Omnes homines libertati. Të gjith njerëzit përpiqen për liri.

Dhanorja etike - dativus ethicus

Dhanorja e përemrave vetorë të vetës së parë dhe të dytë shpreh interesim të gjallë të folësit për atë që thotë. Një dhanore e tillë quhet dhanore etike (dativus ethicus). Në latinisht gjendet më shumë në fjali pyetëse dhe drejtohet nga një folje, por edhe nga një mbiemër. Psh.:

Quid mihi agit Atticus. Ç'më bën Atiku?

At tibi repente venit ad me Caninus. Kurse papritmas po vjen tek unë Kanini.

Shënim: Dhanore e ngjashme gjendet në këto shprehje.

Quid tibi vis? Ç'do ti? Ç'ke ndër mend?

Quid sibi vult haec res? Ç'do të thotë kjo gjë?

Dhanorja e qëllimit - dativus finalis

Dhanorja në gjuhën latine shpreh synim, qëllim dhe quhet dativus finalis. Dhanorja e qëllimit rëndom gjendet pranë foljeve: esse (jam, shërbej si), mittere (dërgoj), reliquere (lë prapa), accipere (pranoj), ducere (regjistroj), vertere (shënoi si), deligere (zgjedh), habere (kam, marr).

honoris esse (jam për nderë të...)

exemplo esse (shërbej si shembull)

vitio vertere (për të shënuar si faj, gabim)

dono dare (jep si dhurat)

auxilio mittere (dërgoj për ndihmë)

praesidio relinguere (lë si mbrojtje)

ludibrio habere (vë në lojë)

quaestui habere (përdor në dobi vetjake)

religioni habere (fjalë për fjalë marr diçka si dyshim shpirtërorë)

subsideo venio (vij në ndihmë)

receptui canere (i bie trumbetës për tërheqje)

Pranë dhanores së qëllimit rëndom përdoret edhe dhanorja e interesit. Në këtë mënyrë, përftohet gjedhja e fjalisë me dhanore të dyfishtë.

Dhanorja e dyfishtë - dativus duplex

Labor nobis honoris est. E kemi për nder punën.

Sociis auxilio venit. U shkoni në ndihmë shokëve.

Dhanorja veç qëllimit të veprimit mund të tregojë edhe efektin e veprimit.

P.sh.: Numa fiducia calamitatis esse solet. Besimi i tepëruar zakonisht të çon në fatkeqësi.

Në këtë ndërtim dhanorja del me foljet:

1. Sum (jam), fio (bëhem):
2. duco (çoj), do (jap), habeo (kam), tribuo (jap), verito (kthej) etj.
3. accipio (pranoj, mitto (dërgoj) etj.

Kësaj dhanorje shpesh i shtohet edhe një dhanore tjetër që shpreh personin të cilit i intereson në një farë mënyre çështja a gjëja.

Virtus sola nemini dono datur. Virtuti është i vetmi, që nuk i jepet askujt dhuratë.

Leges omnibus civibus utilitati: sunt. Ligjet janë për dobinë e të gjithë qytetarëve.

Po kësaj dhanorje i përkasin edhe këso ndërtimesh:

- admirationi sum alicui (i vlej dikujt si admirim)
- adio sum alicui (jam i urryer prej dikujt)
- usui sum alicui (jam në përdorim të dikujt).

Rasa rrjedhore - casus ablativus

Në rrjedhoren latine janë shkruar tri rasa të vjetra ablativi (rrjedhorja, locativi (vendorja) dhe instrumentali (rasa e mjetit). Për këtë arsye rrjedhorja paraqitet në tri kuptime themelore.

1) Si rrjedhore e mirëfilltë gjendet me pyetjet: prej kujt, nga kush? dhe tregon pikën nga e cila shtjellohet veprimi ose niset (ablativus separationis). Ky është kuptimi origjinal i ablativit, që është përmbajtur në emrin e tij (ablativus nga aufero, auferre, ab, fituli, ablatum "ndaj"). Një ablativ të tillë i përgjigjet në gjuhën tonë më së shumti rrjedhorja me parafjalë prej ose emërorja me parafjalën nga.

2) Si rrjedhore e mjetit (ablativus instrumentalis) gjendet kryesisht me pyetjen: me çfarë? dhe tregon mjetin me të cilin kryhet veprimi . Kësaj rrjedhurje në gjuhën tonë i përgjigjen shprehjet parafjalore në rrjedhore dhe në rasa të tjera.

Rrjedhorja e ndarjes - ablativus separationis

Rrjedhorja e ndarjes shpreh vendin nga nis veprimi ose objekti, nga ndahemi shkëputemi nga marrëdhëniet. Në kuptimin e parë, rrjedhorja gjendet pas foljesh që shprehin lëvizje, kurse rrjedhorja mund të jetë:

a) një emër qyteti ose i një ishulli të vogël:

Proficisci Roma, Athenis, Corinthia, Delphis, Rodo. Nisem nga Roma, Athina, Korintheta, Delfi, Rodo.

b) emrat domus ose rus:

Dono / rus venio. Vij nga shtëpia/fshati.

Nëse pranë emrit të vendit gjendet ndajshtimi, atëherë para tij gjendet parafjala, pa marrë parasysh nëse ndajshtimi zë vend përpara emrit a pas tij, p.sh: ex urbe

Roma (prej qytetit të Romës, nga qyteti i Romës). Tusculo, ex clarissimo municipio. (Prej Tuskulit, municipit shumë të famshëm).

Shënim: Parafjala ab pranë emrit të vendit shpeshherë shënon rrethinën e tij P.sh.:

Dux a Mutina discessit. Udhëheqësi u nis nga rrethina e Mutinës.

Rrjedhorja e prejardhjes - ablativus originis

Rrjedhorja e prejardhjes shpreh objektin nga e ka prejardhjen një person. Kjo rrjedhore drejtohet nga pjestorët: natus (i lindur), prognatus (i lindur), genitus (i ngritur), dhe editus (i ngritur). Vetë rrjedhorja e prejardhjes shprehet me emrat: familia (familja), locus (derë), genis (fis).

Romulus Marte natus est. Romuli ka lindur nga Marsi (Është i biri i Marsit.

Familia plebia natus est. Ka lindur në një familje blejbejsh.

Loco nobili ortus. Rrjedh nga një derë fisnike.

Kur jepet prejardhja sipas nënës, pranë pjesoreve gjendet më së shumti rrjedhorja me parafjalën ex, psh.:

Servius Tullius ex servo ortus est. Serviu Tulliu lindi nga një skllave.

Parafjala ex gjendet pranë përemrave.

Bestiae ex natus diligunt. Shtazët i duan këlyshët e vet.

Prejardhja më e largët jepet me rrjedhore me parafjalën a ose ab, p.sh.:

Belgae a germanos arti sunt. Belgët kanë rrjedhur nga gjermanët.

Galis se omnes a Dite parte progatus praedicant. Galët të gjithë krenohen se kanë rrjedhur nga babai Dit.

Rrjedhorja e krahasimit - ablativus comparationis

Kjo rrjedhore gjendet pranë krahasores së mbiemrave dhe ndajfoljeve në vend të ndërtimit me quam dhe emërore ose kallëzore. Emri në rrjedhore shpreh objektin me të cilin krahasohet një send a person i shprehur nga një gjymtyrë tjetër:

Tunica propior pallio est. Tunika / këmisha është më e afërt sesa palltoja.

Neminem. Iscurgo malorem virum / acedaemon tulit. Asnjë burrë më të madh se Likurgun nuk ka Lakedëmoni.

Shënim: Në fjalinë mohore ose në fjalitë pyetëse me kuptim mohues më së shpeshti përdoret rrjedhorja sesa ndërtimi me quam:

Nemo Hercule fortio, nemo lovo sapientior. Askush nuk është më i fortë se Herkuli, më i mençur se Jupiteri.

Quis fuit Hercule fortior. Kush qe më i fortë se Herkuli?

Rrjedhorja vendore - ablativus loci

Rrjedhorja vendore shpreh vendin ku realizohet veprimi. I përgjigjet pyetjes ku? Një rrjedhore e tillë gjendet pas foljesh që shprehin veprim statik, ose me folje të lëvizjes për të shprehur drejtimin e lëvizjes ose dhe vendin nëpër të cilin realizohet veprimi.

Rrjedhorja vendore mund të jetë:

a) një emër vendi, kryesisht emër qyteti a emri i një ujdhese të madhësisë së vogël, singularia tantum të lakimit I dhe II.

Eodem tempore Athenis, Napoli, Salamine terra modus fuerunt. Në të njejtën kohë në Athinë, në Napoli e në Salominë kanë rënë tërmete.

Romani idoneo loco castra fuerunt. Romakët e ngritën kampin në një vend të përshtatshëm.

Exercitus Appia via profectus est. Ushtria u nis rrugës së Appias.

b) një emër i shoqëruar nga mbiemri tota që e paraqet vendin si tërësi të pandashme; mund të përdoret edhe libro si ablativus loci, kur është fjala për librin në tërësi, po jo kur është fjala për pjesë të ndryshme të tij; në këtë rast ai vihet në rrjedhore me parafjalën in:

Clamor tota urbe factuci est. Zhurma u ngrit në tërë qytetin.

primo libro, në librin e parë, por in primo libro, në një ose disa pjesë të librit të parë.

c) shprehja terra marique (në tokë dhe në detë):

d) emrat: domus (shtëpi), rus (fshat), humus (tokë).

Domi moneo - Rri në shtëpi.

Ruri habito. anoj në fshat.

Humi faceo, Shtrihem në tokë.

Kjo rasë përdoret edhe në disa shprehje të ngurosurat: domi bellique (në betejë), domi militaeque (në luftë), domi mea (tua) sua (në shtëpinë time, te unë, te ti, te ai).

In domo mea furtum factum est. Në shtëpinë time është bërë një vjedhje.

e) me foljet: cogo, congreco, contrabo, convenio (të gjitha me kuptimin mbledh), concurro (mblihem me vrap), convenio (takohem) advenio, prevenio (arrij), appello (i afrohem bregut me anije) emri përdoret me rrjedhore, në qoftë se shpreh vend statik, i përgjigjet pyetjes ku? por vihet në kallëzore, në qoftë se shpreh drejtimin e lëvizjes.

Rrjedhorja e kohës - ablativus temporis

Rrjedhorja në latinisht mund të shprehë edhe kohën kur realizohet veprimi. Një rrjedhore e tillë jepet:

a) me emra që emërtojnë kohë ose fragmente kohore, si: tempus (kohë), actas (stinë), ver (pranverë), hiems (dimër), dies (ditë), nox (natë), mensis (muaj), annus (vit), hora (stinë) etj.

b) me emrat: initum (fillim), adventus (arritje), itus (dalje) etj.

c) emrat e festave, të lojërave, të mbledhjeve:

Hieme fumina rara sunt. Në dimër rrufetë janë të ralla.

Rrjedhorja mund të shprehë edhe kohën në zgjatjen e saj. I përgjigjet pyetjes: për sa kohë? brenda sa kohësh?

Emrat që kanë kuptim kohorë gjithmonë gjenden me parafjalë.

Rrjedhorja e mjetit - ablativus instrumenti

Sipas kuptimit të vet themelor. Kjo rrjedhore tregon veplën ose mjetin me të cilin kryhet veprimi i foljes.

Hamo pisces capimus. Me grep zëmë peshq.

Senex baculo nititur. Plaku mbahet me shkop.

Rrjedhorja e mjetit vjen pranë. Plaku mbahet me shkop.

Rrjedhorja e mjetit vjen pranë këtyre foljeve:

a) pranë foljeve kalimtare dhe jokalimtare: utor (përdor), fruor (gëzoj), fungor (ushtroj), vescor (ushqehem) dhe patior (vuaj):

gladio uti (përdor shpesh)

gaudio frui (gëzoj, shfrytëzoj gëzimin)

b) pranë foljeve që në gjuhën latine shënojnë një mjet:

pila ludere (luaj me top) fidibus, tibus canere (ibie lyrës, fyellit)

c) pranë foljeve të tilla, si:

instruere (ushtroj), erudire (mësoj), instituere (jap mësim).

assue, facere, exercere (e mësoj, ushtroj dikë).

Rrjedhorja e mjetit gjendet edhe me foljet.

abundare (kam me bollëk), redundere (vështroj), anerare (rendoj, ngarkoj), etj.

Kjo rrjedhore gjendet edhe pranë mbiemrave:

refertus donis (i mbushur, plot me dhurata)

onustus merce (i ngarkuar me mall) etj.

Rrjedhorja e mënyrës - ablativus modi

Rrjedhorja e mënyrës e tregon mënyrën se si kryhet veprimi i foljes. Në këtë rrjedhore gjenden emrat që vetvetiu shënojnë mënyrën, P.sh.: modo (në/sipas mënyrës), more, ritu (sipas zakonisht), consuetudine (sipas zakonisht), pastaj emrat iuro (me të drejtë), merito (me meritë), vi (me dhunë), dolo (me mashtrim), lege (sipas ligjit), causa (rastësisht), consilio (me vendim, me plan, me qëllim), condicione (me kusht):

Homines olim bestiarum modo vivehant. Njerëzit diku jetonin në mënyrën e shtazëve.

Dux more Romano hostias immolahant. Udhëheqësi flijonte viktimat sipas zakonit romak.

lure Hannibal summis imperatoribus conferunt. Hanibali me të drejtë krahasohet me udhëheqësit më të mëdhej.

Emrat e tjerë e shprehin mënyrën me rrjedhore pa parafjalë ose me rrjedhoren me parafjalën cum. Konstrukt më i rëndomtë është pa cum.

Flumen Arar in Rhodanum incredibili lenitate influit. Lumi Arar me ngadalësi të pabesueshme derdhet në Ronë.

Orestes et Pylades magna fide amicitiam coluerunt. Oresti dhe Pyladi me besnikëri të madhe e kultivuan miqësinë.

Rrjedhoren e mënyrës shpeshherë e përkthejnë me ndajfolje mënyre.

Rrjedhorja e shkakut - ablativus causae

Rrjedhorja që tregon shkakun e veprimit, quhet rrjedhore shkak (ablativus causae) dhe i përgjigjet pyetjes: pse? për ç'arsye?

Res publicam Romana avaritia et luxuria laborabant. Shteti romak vuante nga lakmia dhe luksi.

Oderunt pessore boni virtutis amore. Të mirët e urrejnë gabimin nga dashuria për virtytin.

Duke qenë se edhe shkakun mund të mbahet si mjet, edhe ai ablativ numërohet si rrjedhore instrumentale.

Rrjedhore shkakun më të shpeshta janë ata emra që shënojnë gjendje shpirtërore: amore (dashuri), avaritia (kopraci), ira (zemërim), metus (frikë), iussu (drejtësi), rogatus (lutje). Pranë rrjedhores së shkakut shpesh gjendet pjesorja e së kaluarës pësore që rëndom nuk përkthehet, si psh.:

amore impulsus (i shtyrë nga dashuria); ira inflammatus (i ndezur nga urrejtja); metu coactus (nga frika); inopiae adductus (nga skamja).

Rrjedhorja e shkakut përdoret pranë foljeve dhe mbiemrave që shënojnë disponim psikik dhe ndjenjë trupore.

gaudeo, laetor victoria (gëzohem për shkak të fitores); doleo, maereo morte (ndiej dhimbje për shkak të vdekjes);

labor fame (vuaj nga uria) etj.

Rrjedhorja e cilësisë - ablativus qualitatis

Kjo rrjedhore tregon cilësinë dhe gjithmonë ka pranë vetes përcaktorë si dhe gjinorja e cilësisë. Ablativus qualitatis përdoret posaçërisht për të shënuar vetitë trupore dhe shpirtërore.

Caesar fuit excelsa statura, colore condido, nigris oculis. Cezari ka qenë shtatëgjatë, lëkurbardhë, syzi.

Bono animo sum in Catonem. Kam qëndrim miqësor ndaj Catonit.

Aristoteles, vir summo ingenio, prudentiam cum, eloquenti iunxit. Aristoteli, burrë shumë i zgjuar, bashkoi urtësinë me gojëtarinë.

Rrjedhorja e shoqërimit - ablativus sociativus

Rrjedhorja e shoqërimit tregon shoqërimin ose përcjellje. Rëndom e përcjell parafjala cum. Pa parafjalë si rrjedhore shoqërimi dalin emrat që shënojnë përcjelljen ushtarake, siç janë: copiae, exercitus, miles, kur kanë pranë vetes përcaktor mbiemrorë, psh.:

Dardani ingentibus copiis in Macedoniam dranscenderunt. Dardanët me trupa të pamasë kaluan në Maqedoni. Nëse këta emra kanë si përcaktor një numërorë, pranë tyre gjithmonë gjendet parafjala cum, psh.:

Caesar cum nongentis equitibus in castra pervenit. Cezari ka arritur me nëntëqindë kalorës në kamp.

SINTAKSA E FOLJES

Verbum finitum - folje të caktuara

Verbum infinitum - folje të pa caktuara

Kur folja është në dëftore, në lidhore ose në urdhërore është e përcaktuar për nga veta, përkatësisht për nga kryefjala që kryen veprimi, prandaj quhet folje e caktuar (verbum finitum). Trajtat e emrave prejfoljor nuk kanë shenjë vetë, prandaj quhen folje të pacaktuara (verbum infinitum).

Paskajorja - infinitivus

Në gjuhën latine dallojmë tri paskajore:

1. Paskajorja e së tashmes në veprorë dhe pësore.

P.sh.: laudare, monere, scribere, audire

laudari, moneri, scribi, audi

2. Paskajorja e së kryerës në veprorë dhe në pësore

P.sh.: laudavisse, monuisse, scripsisse, audivisse,

laudatum esse, monitum esse, scriptum esse, auditum esse

3. Paskajorja e së ardhmes në veprorë dhe në pësore

P.sh.: laudaturum esse, moniturum esse, scripturum esse, auditorum esse

laudatum iri, monitum iri, scriptum iri, auditum iri

Paskajorja e së kryerës në pësore dhe paskajorja e së ardhmes përdoret në ndërtimin e accusativus cum infinitivus, prandaj janë dhënë këtu në kallëzore njëjës.

Paskajorja si kryefjalë

Paskajorja përdoret si kryefjalë:

a) pranë foljeve pavetore siç janë: decet, praestat, oporiet, pudet etj.

b) pranë foljes ndihmëse esse dhe pranë foljeve të tjera këpujore me kallëzues emërorë.

a) Accipere praestat quam inferre iniuram. Më mirë do të ishte ta vuajsh padrejtësinë sesa të bëshë.

Oratorem irasci minime decet. Aspak nuk do t'i kishte hije gojëtarit të zemërohej;

b) Dulcet et decorum est pro patria mori. Do të ishte diçka e këndshme dhe e ndershme të vdesësh për atdhe.

Mentiri nefas putatur. Rrena mbahet për mëkat.

Paskajorja si kallëzues

Nëse kryefjala është paskajore e një folje këpujore, kallëzuesi emërorë pranë saj gjendet në kallëzore.

Turpe est mendacem esse. Është turp të jeshë rrenacak.

Consulem fieri Mario valde utile videbatur. Të bëhej konsull, Mariut i dukej diçka shumë e dobishme.

Kallëzorja me paskajoren - accusativus cum infinitivus

Video amicam venire. Po shoh se miku po vjen.

Pranë foljes kalimtare video kemi dy kundrina: kundrina e vetës (amicum) dhe e sendit (venire). 1. Po shoh mikun për të ardhur dhe 2. Po shoh se niku po vjen. Një konstrukt i tillë, ku kryefjala na paraqitet në kallëzore kurse kallëzuesi në paskajore quhet accusativus cum infinitivus.

Kallëzorja me paskajoren përkthehet me fjali kundrinore me lidhëzën se, në të cilën kallëzorja e gjuhës latine del në kryefjalë, kurse paskajorja në kallëzues, dhe atë më kohën në të cilën gjendet paskajorja.

Kallëzorja me paskajoren është një fjali e varur në të cilën kryefjala gjendet në kallëzore dhe folja kthehet në paskajore. Në të shumtën e rasteve kjo fjali e varur përdoret në gjuhën latine kur në fjalinë e pavarur gjenden:

1. një folje dicendi, sentiendi, voluntatis;
2. njëra nga foljet: iube, veto, sino, patior;
3. një njësi sintaksore e formuar prej një mbiemri asnjëanës ose një emër dhe folja ndihmëse esse.

Emërorja me paskajoren - nominativus cum infinitivus

Ndërtimi emërore me paskajore përdoret si një fjali e varur ku në fjalinë kryesore gjendet një folje në diatezën pësore. Ky konstrukt përkthehet me një fjali kundrinore, duke kuptuar emëroren si kryefjalë dhe paskajoren si kallëzues.

P.sh.: Nanatur Illyrii barbaros vicisse. Tregohet se ilirët i mundën barbarët.

Pjesoret, mbiemrat dhe emrat si pjesë të kallëzuesit gjenden në emërore duke u përshtatur me kryefjalën. Nëse në ndërtimin emërore me paskajore kryefjala është një përemër vetor, ky nuk figuron fare sepse kryefjala kuptohet prej foljes kryesore.

P.sh.: Magnus esse videtur. Duket se ai është i madh.

Magnus esse videris. Po duket se ti je i madh.

Në të shumtën e rasteve emërorja me paskajoren varet prej këtyre foljeve të diatezës pësore:

dicor (flitet), putor (konsiderohet), credor (besohet), videor (duket), traditur (tregohet, iubeor (urdhërohet).

Pjesorja - participium

Në gjuhën latine dallojmë tri pjesore:

- a) pjesorja e së tashmes veprare: laudans, gen. laudantis;
- b) pjesorja e së kryerës pësore: laudatus, a, um;
- c) pjesorja e së ardhmes veprare: laudaturus, a, um;

Pjesorja është një lloj mbiemri foljor.

a) Pjesorja e së tashmes përkthehet:

- me mënyrën përcjellore;
- me një fjali të varur (lidhore, kohore, shkajkore, lejore, kushtore);
- me shpreje parafjalore;
- me një fjali të pavarur të lidhur me lidhëzen; dhe (et).

Graeci Troiam expugnatam inflammaverunt. Grekët i dhanë zjarr Trojës së pushtuar, ose: pasi që e pushtuan, ose: pas pushtimit, ose grekët e pushtuan Trojën dhe i dhanë zjarin.

b) Pjesorja e së kryerës përkthehet me mbiemrin foljor pësor ose, sikurse pjesorja e së tashmes, me një fjali të varur, shprehje parafjalore, fjali të pavarur.

Spartacus servos liberaturus arma cepit. Spartaku rroku armët duke dashur t'i çlirojë skllëverit, ose për të çliruar skllëverit.

c) Pjesorja e së ardhmes veprare përkthehet me: duke dashur (me qëllim, duke pasur qëllim) dhe me një fjali qëllimore, ose me paskajore.

Zgjedhimi vepror perifrastik - coniugatio perifrastica activa

Në gjuhën latine përveç katër zgjedhimeve të foljeve, dallojmë edhe zgjedhimin perifrastik ose përshkrues, i cili trajton veprorën dhe pësoren.

Pjesorja e së tashmes veprare e bashkuar me foljen ndihmëse esse përbën zgjedhimin përshkrues të veprares, i cili përdoret në të gjitha kohët. Koha veta dhe numri përcaktohen nga folja ndihmëse. Folja në këtë zgjedhim tregon gatishmërinë që të kryhet një punë.

Psh.: Discipuli linguam Latinam didicturi erant. Nxënësit deshën të mësonin gjuhën latine.

Rrjedhorja absolute - ablativus absolutus

Një fjali e pavarur e formuar prej një pjesorje dhe një emëri ose përemëri në rrjedhore quhet ablativus absolutus ose rrjedhore e lirë ose absolute. Në këtë ndërtim pjesorja është e shkëputur prej fjalisë nga e cila varet.

Caesar in Rheno ponte facto exercitum in Germaniam duxit. Kur ndërtoi urën Cezari i priu ushtrisë në Gjermani.

Rrjedhorja e lirë ka zakonisht kuptim kohor, prandaj më së shpeshti kthehet me fjali kohore, por në të shumtën e rasteve edhe me fjali shkakore, lejore, dhe kushtore, varësisht nga konteksti dhe kuptimi i fjalisë.

Në gjuhën shqipe pjesorja e së tashmes në këtë ndërtim e përkthejnë me të pakryerën:

Caesar regnante...- Kur Cezari mbretëronte.

Por në disa raste kur me rrjedhoren gjejmë emra nderimi, detyre ose moshe atëherë ajo përdoret pa pjesore.

Cicerone consule. Kur Ciceroni ishte konzul.

Gjerundivi - Gerundivum

Gjerundivi është një mbiemër foljor me mbaresat - ndus, - nda, - dum. Ka kuptim pësor dhe tregon një punë a veprim i cili duhet të kryhet patjetër.

P.sh. : laudandus, - nda, - dum

scribendus, - nda, - dum

Kur në një fjali përballë gjerundivit ndodhet një kundrinor i drejtë, atëherë gjerundivi bëhet gjerund. Ky ndryshim bëhet duke vënë objektin në rasën e gjerundit dhe duke e përshtatur këtë me emrin në gjini dhe në numër.

P.sh.: Cupidus legendi librum.

Cupidus libri legendi. Dëshiroj të lexoj librin.

Gjerundi - gerundium

Gjerundi është një emër foljor i gjinisë asnjëanëse me kuptim vepror, që ka vetëm njëjës me katër rasat: gjinore, dhanore, kallëzore dhe rrjedhore. Për rasën emërore i shërben paskajorja e tashme veprorë:

Nom. legere (të lexuarit)

Gen. legendi (i, e të lexuarit)

Dat. legendo (të lexuarit)

Acc. legendum (të lexuarit)

Abl. legendo (prej të lexuarit)

Gjerundi në rasën kallëzore përdoret vetëm me parafjalën ad dhe iter. Kurse e përkthejnë me përcjelloren dhe me një emër të rëndomtë foljor.

P.sh.: Discipuli cupidi sunt discendi. Nxënësit janë të etshëm për të mësuar (për mësim).

Cicero de bene beateque vivendo disputat. Ciceroni bën fjalë për jetën e mirë dhe të lumtur.

Ndërrimi i gjerundit me gjerundiv

Gjerundi kthehet në gjerundiv kur rri një kundrin e drejtë. Kundrina kthehet në rasën e gjerundit kurse gjerundi në gjerundiv i cili përshtatet në gjini dhe numër dhe gjerundivi i këtillë e ka kuptimin e gjerundit.

Gjerund:

Omnes erant cupidi audiendi
oratores.

Gjerundiv

Omnes erant cupidi oratoris
audiendi

Të gjithë ishin të etshëm për të dëgjuar gojtarinë.

Leendo libros erudieris.

Libris legendis erudieris

Duke lexuar libra do të arsimohesh.

Zgjedhimi përshkrues pësor - coniugativ periphrastica passiva

Ky zgjedhim formohet kur gjerundivi lidhet me trajtat e foljes ndihmëse esse. Ky zgjedhim ka kuptimin e domosdoshmërisë që të kryhet një punë, ndërsa trajtat e foljes esse tregojnë kohën në të cilën kryhet puna apo veprimi në fjali.

P.sh.: Carmina Homeri legenda sunt. Këngët e Homerit duhet lexuar.

Formën pësore të zgjedhurit përshkrues e përkthejnë me foljet: duhet, duhet patjetër, vlen, dhe atë në kohën në të cilën gjendet folja esse dhe paskajoren ose pjesoren e foljes përkatëse. Kurse kur folja është mohore, atëherë e përkthejm me foljet: nuk është e domosdoshme, nuk guxohet, nuk mundet. Formën pësore e përkthejm me fjali në konstruktin vepror, ku kryefjala e fjalisë latine kthehet në kundrinë.

Discipulo liber legendus est. Nxënësi duhet (patjetër) të lexoj librin.

Supini

Supini është emër foljor i lakimit të katërt. Në gjuhën latine dallojm dy supina:

- a) Supini me -um; vjen mjaft rrallë dhe rri me foljet që tregojnë lëvizje, sikurse: iri për të shkuar,

Legio frumentatum missa est. Legjioni u dërgua për të mbledhur drithë.

- b) Supini me - është sipas prejardhjes rasa dhanore e lakimit të katërt e cila është njësuar me rasën rrjedhore dhe vjen me mbiemrat siç janë: facilis i lehtë, difficilis i vështirë, incredibilis i pabesueshëm, harribilis i tmershëm, turpis i turpshëm, dhe me emrat: fas e drejtë, nefas mëkat. E përkthejm me paskajoren.

SINTAKSA E FJALISË

Gjymtyrët e fjalisë

Struktura e fjalisë në gramatikën e latinishtes shihet si kombinim a si marrëdhënie e subjektit me predikatin dhe të zgjeruesve të tyre. Subjekti dhe predikati janë përbërësit bazë ose themelorë të fjalisë. Këta quhen edhe gjymtyrët kryesore. Fjalët e tjera që plotësojnë kuptimin e gjymtyrëve kryesore quhen gjymtyrë të dyta. Këto gjymtyrë në gramatikën latine nuk janë dalluar me vete, me përjashtim të cilësorit e të ndajshtimit.

Mendim i shprehur nga një fjali me dy gjymtyrët kryesore është më i kufizuar, ndërsa, kur këto janë të plotësuar me gjymtyrë të dyta, mendimi bëhet më i pasur, më i plotë. Si subjekt dhe si predikat, ashtu si në gjuhën shqipe, shprehen po me ato pjesë ligjrate.

Kryefjala - subjectum

Subjekti (kryefjala) është ajo gjymtyrë kryesore e fjalisë që shpreh frymorin a sendin për të cilën flitet në fjali:

Osos arguit non esse Germanos quod tributa pat iuntur. Osët nuk janë gjerman se bëjnë lëshime për nderin.

Inimici sunt multi. Armiqtë janë të shumtë.

Subjekti i fjalisë mund të jetë:

1) një emër: Sol lucet. Dielli shkëlqen.

Experientia docet. Përvoja mëson.

2) një mbiemër i emërzuar:

Sapiens est beatus. I dituri është i lumtur.

Vieti in urbem refugerunt. Të mundurit u strehuan në qytet.

3) një përemër:

Hoc erat in vestis. Kjo është e dëshirueshme.

Omnibus discendum est. Të gjithë duhet të mësojnë.

Nostri venerunt. Tanët erdhën.

Kur kryefjala është përemër vetor i vetës së I ose II shprehet vetëm atëherë kur theksohet ose kur është e kundërvënë:

Praeditia mea tu possidis, ego a linea misericordia vivo. Punën time e zotëron ti, unë jetoj me mëshirën e huaj.

4) një folje në paskajore:

Errare humanum est. Të gabosh është njerëzore.

5) një fjali e tërë:

Imperare sibi maximum imperium. Të komandos vetën, është mbretëria më e madhe.

Dulce et decorum est pro patria mori. Është e ëmbël dhe e hijshme të vdesësh për atëdheun.

Emrat dhe përemrat e përdorur si subjekt i fjalisë janë zakonisht në rasën emërore dhe quhen në këtë rast subjekti gramatikor, por edhe nëse përdoret në një rasë tjetër, quhet subjekt logjik.

Piget me. Kam mërzi. Më vjen keq.

Sunt homines. Ka njerëzi.

Kallëzuesi - predicatum

Predikati (kallëzuesi) është gjymtyra kryesore që shpreh një veprim, një gjendje ose një tipar të kryefjalës.

Defende rem publicum. Mbrojta republikën

Duo bella eo ano prospere gestu sunt. Dy luftëra u bënë atë vit me dëshirë.

Predikati është foljor dhe emërorë. Predikati foljor (predicatum verbum) shprehet me folje:

Athenienses gloriam apud omnes gentes erant consecut. Athinasit kishin fituar lavdi në të gjithë popujt.

Marcua discit. Marku po mëson.

Predikati emërorë (predicatum nomen) shprehet me emër, me mbiemër, me pjesore, me përemër dhe me numëror, të cilët mund të lidhen drejtpërdrejt me subjektin ose me ndihmën e foljes esse, e cila quhet këpuj:

Folja esse mund të mos përdoret, kur predikati emëror shprehet me emër ose me mbiemër cilësor; ka në këtë rast një gjendje të hershme, të ruajtur.

Brindisium urbs Apulies. Brindizi është qytet. Apulies.

Si tu et Tullia valetis, ego et suavissimus Cicero valemus. Nëse ti dhe Tullia jeni të fortë, edhe unë dhe i ëmbli Ciceron të fortë jemi.

Përshtatja e kallëzuesit me kryefjalën

Predikati foljor dhe folja esse e predikatit emëror përshtaten me subjektin në numër dhe në vetë:

Ego scribo, tu legis. Unë shkruaj, ti lexon.

Emri si predikat emëror përshtatet me subjektin në rasë dhe në numër:

Usus magister est optimus. Përvoja është mësues shumë i mirë.

Mbiemri si predikat emëror përshtatet me subjektin në gjini, numër dhe rasë.

Pater est bonus. Babai është i mirë.

Kur në fjali ka dy ose më shumë subjekte, përshtatja bëhet në këtë mënyrë: Nëse subjektet janë frymorë, gjymtyra emërore e predikatit vihet në shumës dhe në gjininë e kryefjalës, po të jenë gjinishë të njejta; po të jenë gjinishë të ndryshme, sundo mashkullorja, por mund të përshtatet edhe me kryefjalën e fundit:

Pater et filius boni sunt. Babai dhe djali janë të mirë.

Mater et filia bona sunt. Nëna dhe vajza janë të mira.

Nëse subjektet janë sende abstrakte, gjymtyra emërore vihet zakonisht në gjininë asnjëanëse, po të jenë kryefjalët gjinisë të ndryshme.

Agri vicini cultoribus vacui sunt. Fushat dhe fshatrat janë të zbratur.

Secundae res honores, imperia fortuita sunt. Sukseset, nderi i pushtetit janë të rastit.

Emra të tillë të përgjithshëm, si: multitudo (shumicë), turba (turmë), pars (pjesë), exercitus (ushtri), classis (flotë) etj. e kërkojnë predikatin në shumës:

Turba sen iorum adventum hostium expectabant. Turma e më të vjetërve po presin ardhjen e armiqve.

Pars navium haustae sunt. Një pjesë e anijeve janë shkatërruar.

Nëse si subjekt i fjalisë janë përemrat: quisque (secili), uter (njëri prej të dyve), iterque (njëri e tjetri) ose një togfjalësh emër + emër në gjinore shumës ose emër me parafjalën eum, predikati vihet shumës. Në këtë rast përshtatje sipas kuptimit:

Uterque eorum exercitum educunt. Secili prej tyre morën ushtrinë.

Magna multitudo hominum in urbem convenerunt. Një shumicë e madhe njerëzish u mbledhën në qytet.

Gjymtyra emërore e predikatis përshtatet në gjini me ndajshkrimin e një emri gjeografik të tillë, si: urbs (qytet), oppidum (qytet i vjetër), colonia (koloni), insula (ujdhesë), mons (mal) etj.:

Coriol, oppidum Valsorum, captum est. Korioli, qyteti i Valskorëve, ishte pushtuar.

Thebae, urbs Boetiae, clarissima fuit. Teba, qytet i Beotisë, ka qenë e famshme.

Cilësori - atributum

Cilësor quhet mbiemri a pjesorja që shërben për të përcaktuar kuptimin e një emri a të një përemri, me të cilin lidhet drejtpërdrejt, pa ndërmjetësinë e ndonjë fjale tjetër. Cilësori mund të jetë një mbiemër, një pjesore e përdorur si mbiemër, një përemër, një numëror, por edhe një folje në paskajore ose një ndajfolje: vir magnus (burrë i madh), femina magna (grua e madhe), animal magnum (kafshë e madhe):

Hominis utilitati agri omnes et maria parent. Interesit të njeriut i shërbejnë të gjitha tokat dhe detet.

Bonae leges rem publicam servant. Ligjet e mira mbrojnë shtetin.

Mbiemri si cilësor përkon në gjini, në numër e në rasë me emrin që përcakton.

Romanis euntae terrae marique patebant. Për romakët të gjitha vendet e detit ishin të haruara.

Nëse cilësori u referohet shumë emrave, përkon me emrin më të afërt ose përsëritet pranë secilit emër, sidomos kur janë gjinishë të ndryshme: senatus populus Romanus. Senati dhe populli romak; por bona urbs et banus civis.

Si cilësor përdoret edhe një emër në gjinore, i cili qëndron rëndom pas emrit që përcakton: hortus patris. Kopshti i babait; consilium Apollinis këshillat e Apollonit.

Mund të përdoret si cilësor edhe një emër me parafjalë i cili gjithashtu pasvendoset. Një cilësori të këtillë i shtohet pjesorja: pugna Salamina lufta e Salaminës ose pugna ad Salamina commissa. Lufta e bërë pranë Salaminës.

Pranë një emri të përveçëm nuk mund të përdoret cilësori, veç nëse midis emrit të përveçëm dhe cilësorit gjendet një emër i përgjithshëm ose përemri ille: Caesar, vir clarissimus. Cezari, burrë i shquar, ose Caesar, ille clarissimus. Cezari ai i shquari.

Ndajshtimi - appositio

Ndajshtimi është një emër, një togfjalësh ose një fjali e tërë, që vendoset pranë një emri tjetër për të përcaktuar a për të sqaruar më tej kuptimin e tij. Në latinisht ndajshtimi përshtatet me emrin që përcakton në numër dhe në rasë. Ndajshtimi lidhet me emra që emërtojnë profesione, tituj, grada, marrëdhënie farefisi. Ndajshtimi që vihet pas një fjale të tillë, është një emër i përveçëm njeriu, vendi, emër i një rruge a sheshi, emër i një institucioni etj.

Oppidum Alexandria a conditore dictum est. Qyteti Aleksandria u quajt sipas themeluesit të vet.

Provincia Illyricum a Teberio potat est. Provincën Ilire e pushtoi Tiberi.

Ndajshtimi mund të lidhet edhe me emra të përveçëm, në këtë rast ai është një emër i përgjithshëm:

Antonius et Augustus apud Philipos, Macedoniae urbem, contra Brutum et Cassium pugnaverunt.

Antoni dhe Augusti pranë Filipëve, qytet i Maqedonisë, luftonin kundër Brutit dhe Kasit.

Kur ndajshtimi është substantive mobile përkon me fjalën e përcaktuar në gjini, numër dhe rasë:

Epicurus philosophus. Epikuri, filozof.

Emrat që emërtojnë llogjepe, si ndajshtime, vihen në numrin shumës, nëse u referohen dy a më shumë emra njerëzish: Tiberus et Caius Gracchi (Tiberi dhe Kaiusi, Grekët), Marcus et Quintus Cicerones (Marlen dhe Kuinti, Ciceronët).

Disa emra, si: rex, imperatore, dhe emrat gjeografikë: mons (kodër), flumen (lumë), locus (vend), urbe (qytet), si ndajshtime qëndrojnë para emrit të përveçëm që i referohen: imperator Augustus (Augusti, mbreti), urbs Roma (Roma qytet), flumen Rhodanus (Rodoni, lumi).

Përdorimi i mënyrave në fjali të pavarur

Në gjuhën latine fjalitë janë të pavarura në fraza dhe periudha, pra si në gjuhën shqipe. Në fjalitë e pavarura përdoren sipas kuptimeve dhe mënyrave të ndryshme. Kështu mënyra dëftore (indicativus) tregon një gjë që e marrim si të vërtetë, reale, kurse mënyra urdhërore (imperativus) tregon një urdhër ose një ndalim. Kurse mënyra lidhore (coniunctivus) shpreh një urdhër, ndalim, vërejtje, mundësi, dëshir, lejim dhe ndryshim.

Mënyra lidhore në fjalitë e pavarura

Mënyra lidhore në fjalitë e pavarura shpreh: nxitje, ndalim, mundësi dhe dëshirë. Mënyrën lidhore e kanë të gjitha kohët e gjuhës latine përveç kohës së ardhme. Por kjo mënyrë foljore përdoret te fjalitë e varura dhe atë të pavarur.

P.sh.:

Laboremus! Të punojmë!

Amicum ne deseras! Mos e braktis mikun!

Dicat / dixerit quis. Dikush kishte për të thënë.

Vivat patria nostra! Roftë atdheu ynë!

Mënyra dëftore

Kjo është mënyra me të cilën shprehet vullneti, dëshira, mundësia ose përgjithësisht ndonjë mendim i atij që flet. Pra është mënyra e paraqitjes personale.

P.sh.: Eamus. Të shkojmë.

Valeanti cives mei. Të jenë shëndoshë qytetarët e mi.

Fortasse dixerit quisquam. Ndoshta do të kishte thënë ndokush.

Fjalja dëftore

Fjalja dëftore në latinisht shpreh mundësi dhe nevojë. Këtu më së shumti qëndron mënyra dëftore. Ndërsa në gjuhën shqipe fjalinë dëftore e përkthejnë me kushtoren. Fjalja dëftore haset:

a) me foljet dhe shprehjet: possum, debeo, licet, oportet etj.

Multa dicere possum in hanc sententiam. Shumë mund të thosha në këtë pikëpamje.

b) me zgjedhimin perifrastik pësor:

Hoc est faciendum. Kjo duhej bërë.

c) me folje me përemra lidhorë:

Quidquid id est timeo Danaos et dona ferentes. Ç'do të jetë kjo kam frigë prej danaeve edhe pse sjellin dhurata.

d) Me foljet pranë paene dhe prope:

Paene dixi. Gati do të kisha thënë.

e) me foljet pranë sive-sive:

Sive hoc verum est sive falsum. Qoftë kjo e vërtetë apo e reme.

Fjalja pyetëse

Fjalja pyetëse shërben për të pyetur, zakonisht fillon me një fjalë pyetëse, me përemra, mbiemra ose ndajfolje pyetëse.

Psh.:

Quis vestrum veni? Cili nga ju erdhi?

Ubi fuisti discipule? Nxënës, ku ishe?

Kurse fjalia e pavarur pyetëse kërkon mënyrën dëftore, kurse ato të varur mënyrën lidhore sipas qëllimit të kohës.

Psh.: Non satis constat quando Roma condita sit. Nuk dihet me saktësi se kur është themeluar Roma.

Nescio num hodie magister venturus sit. Nuk e di a do të vijë sot mësuesi.

Fjalia e përbërë

Në gjuhën latine fjalia e përbërë përbëhet nga dy ose më shumë fjali. Kur fjalitë nuk varen nga njëra-tjetra atëherë kemi fjali të përbërë të pavarur ose të bashkërenditur. Nëse një është kryesore dhe tjetra e plotëson fjalinë atëherë fjalia është e përbërë dhe e varur.

Në latinishtë fjalitë e përbëra ndahen në:

- a) pyetëse, urdhërore dhe dëftore.
- b) Kryefjalore, kallëzuese, kundrinore, cilësore dhe ndajfoljore.

Dëftorja në fjalitë e varura

Te fjalitë e varura përdoret mënyra dëftore dhe lidhore por varësisht nga kuptimi. Në veprimin e fjalisë kryesore dhe të asaj të varur janë të njëkohëshme, dhe në të dyja qëndron e njejta kohë: facio, quod possum; feci quod potui: faciam quod potero.

Mirëpo nëse veprimi i fjalisë së varur ka ndodhur para veprimit të fjalisë kryesore të kohës së tashme, fjalisë i përgjigjet e kryera, të ardhmes e ardhmja e përparme: quantum didicisti, tantum scis; quantum didiceras, tantum sciebas; quantum didiceris, tantum scies.

Rregullat e pëlqimit të kohëve - Consecutio temporum

Kur mënyra lidhore e fjalisë së varur pëlqehet me kohët e fjalisë kryesore quhet consecutio temporum.

Për përcaktimin e lidhore në fjalinë e varur duhet të dihen:

- 1) Cilën kohë e kemi në fjalinë kryesore:
- 2) dhe kur ngjanë veprimi i fjalisë së varur.

Në gjuhën latine kohët ndahen në: kohë kryesore dhe kohë historike. Kohë kryesore janë: e tashmja, e ardhmja, e ardhmja e përparme të cilat u bashkangjitet edhe mënyra urdhërore. Kurse kohë historike janë: e pakryera, e kryera dhe e kryera e plotë.

I Kohët kryesore:

a) Quaero }
Quaeram } quid faciat
Quaere }

Pyes }
Do të pyes } ç'bën.
pyet }

b) Quaero }
Quaeram } quid fecerit
Quaere }

do të pyes }
pyes } ç'bëri (ç'ka bëre)
pyet }

c)	Quaero Quaeram Quaere	} quid factum sit	Pyes do të pyes pyet	} ç'do të bëjë
----	-----------------------------	-------------------	----------------------------	----------------

II. Kohët historike

a)	Quaerebam Quaesivi Quaesiveram	} quid faceret	Pyetja pyeta (pate pyetur)	} ç'bënte.
----	--------------------------------------	----------------	----------------------------------	------------

b)	Quaerebam Quaesivi Quaesiveram	} quid fecisset	pyetja pyeta (kam pyetur) (pata pyetur) kisha pyetur	} ç'kishte bërë
----	--------------------------------------	-----------------	--	-----------------

c)	Quaerebam Quaesivi quaesiveram	} quid facturus esset	pyetja pyeta (kam pyetur) kisha pyetur (pata pyetur)	} ç'do të bëjë.
----	--------------------------------------	-----------------------	--	-----------------

Përdorimi absolut i urdhërores në fjalitë e varura

Fjalitë e varura urdhërore janë zhvilluar nga fjalitë me lidhore dëshirore, prohibitive të cilat fjali kanë qenë të pavarura dhe qëndronin si të bashkërenditura pranë një fjalie tjetër. Fjalitë urdhërore janë zhvilluar me lidhëza dhe pa lidhëza që shprehin urdhër për t'u bërë diçka.

P.sh.:

Rogo te dicendi finem facias. Të lutem t'i japish fund fjalimit.

Curo. Ut valeam. Brengosem. O sikur të jem i shëndosh.

Këto fjali shprehin urdhër dhe përpjekje dhe vijn pas fjalisë kryesore në të cilat gjenden këto folje: postulare (për të kërkuar), curare (për tu kujdesur), facere (për të fituar) etj. Gjithashtu fjalitë urdhërore vin pas emrave me est që kanë kuptim të ngjashëm si foljet: curo, lex, munus.

Në gjuhën latine me urdhëroren e parë shprehet një urdhër apo nxitje; servus meus liber esto! Skllavi im të jetë i lirë. Kurse me urdhëroren e dytë rëndom tregohet një urdhër, që është për t'u kryer në të ardhmen. Kjo përdoret në ligje, kontrata dhe teste.

Llojet e fjalive të varura

Fjalitë qëllimore - finale

Këto fjali tregojnë qëllimin e kryefjalës së fjalisë kryesore dhe veprimin e fjalisë së varur që zhvillohet njëkohësisht me anë të fjalisë kryesore. Në këto fjali përdoret mënyra lidhore në kohën e tashme ose në të pakryerën por duke iu nënshtruar rregullave të pëlqimit të kohëve:

P.sh.:

Linguam Latinam discimus, ut facilius scriptores Romanos legamus.
Mësojmë gjuhën latine që të lexojmë sa më lehtë shkrimtarët romak.

Fjalitë qëllimore marin këto lidhëza: ut (që të, për të, me qëllim), ne (që të mos, për të mos), quo (sa, që), qui quae, quod (që të).

Fjalitë kohore - temporale

Te fjalitë kohore përdoret mënyra dëftore dhe lidhore. Mënyra dëftore del me lidhëzat: cum (kur, atëherë kur), antequam (përpara se), postquam (pasi), dum (ndërsa), donec, quoad (derisa), ubi, ut, etj. (sapo, porsa, tek sa, sa). Kurse mënyra lidhore me lidhëzat: cum (me).

Themistocles, ut Lacedaemonem venit, ad magistratus adire noluit. Kur Themistokleu erdhi në Lakedemon, nuk deshti të hyjë në pushtet.

Abite, dum est facultas! Shkoni gjersa e keni rastin!

Fjalitë shkakore - causale

Fjalitë shkakore varësisht nga lidhëzat kërkojnë ose shkojnë me mënyrën dëftore dhe lidhore - Mënyra dëftore te fjalitë e varura shkakore fillon me lidhëzat: quia, quoniam, quod (sepse, pse), kurse mënyra lidhore me lidhëzën cum (cum causale), pse, sepse, për shkak.

Georgius Castriotus, quia magnus res gesserat, Dux et Pater appellatus est. Gjergj Kastrioti u quajtë udhëheqës dhe babë sepse kreu punë të madhe.

Cum filius diligens sit, pater eum laudat. Për arsye se djali ishte i zellshëm, babai e lëvdoi.

Mënyra lidhore që del me lidhëzat quod dhe cum në fjalitë shkakore u nënshtrohet rregullave të pëlqimit të kohëve dhe përdoret kur në fjali del si mendim i huaj.

Fjalitë lejore - concessive

Fjalitë lejore varësisht prej lidhëzave kërkojnë mënyrën dëftore dhe lidhore. Poashtu edhe fjalitë lejore shkojnë me lidhëzën cum e cila kërkon mënyrën lidhore. Por përveç lidhëzës cum hasen edhe këto lidhëza: licet, quamvis, ut (megjithëse, edhepse). Kurse mënyra dëftore shkon me lidhëzat: etsi, etiamsi, tametsi, quam-quam (ndonëse, sadoqë, edhe ose).

Georgius Castriotus etsi periculum videbat tamen forti animo hostibus restitit. Gjergj Kastrioti, edhe pse e kish të qartë rrezikun, prapseprap u bëri ballë armiqëve trimërisht.

Cum tibi non placeant, quae dicturus sum tamen dicam. Megjithëse nuk të pëlqen ajo që dëshiroj ta them prapseprap do të them.

Fjalitë krahasore - comparative

Edhe fjalitë krahasore kërkojnë mënyrën dëftore ose lidhore - Mënyra dëftore kërkohet kur fjalitë shprehin veprim real, por kur shprehin veprim joreal mënyrën lidhore.

Hieme noctes longiores sunt quam aestate. Dimrit netët janë më të gjata se sa verës.

Semper sic vive, tamquam si omnes homines te videant. Gjithmonë jeto sikur kishin me të pa të gjithë njerëzit.

Të shumtën e rasteve fjalitë krahasore që shkojnë me mënyrën lidhore fillojnë me këto lidhëza: quasi, tamquam, velut, ut si, velut si (sikur, si, musiq). Dhe në të shumtën e rasteve hasen edhe këto lidhëza: quot (sa), tot (aq), qualis (si), talis (ashtu), quantus (aq), tantus (aq), sicut (si), ita (ashtu).

Fjalitë rrjedhore - consecutive

Këto fjali shprehin raporte të rrjedhimit kundër fjalitë që varen. Mënyra lidhore e fjalitë pëlqehet me kohën në fjalitë kryesore. Këto fjali dallohen prej frazave të posaçme: ita, sic, adeo, tam (ashtu poashtu), Talis, tantus (aq, aq sa), fit, ut (ndodh që), mos est, ut (është e zakonshme që) quam (saqë) dhe këto fjali fillojnë me lidhëzat: ut (sa, saqë), ut non (saqë e nuk), quin (që të mos, i cili nuk), qui, quae, quod (që, i cili).

Fieri potest, ut errem. Mund të ndodh që gaboj.

In bello nemo militum fuit, quin vulneratur. Në luftë nuk mbeti asnjëri nga ushtarët pa u plagosur.

Fjalitë lidhore - relative

Fjalitë lidhore fillojnë me përemrat dhe mbiemrat lidhor: qui, quimque, quantus, qualis etj. ose me ndajfoljet lidhore ubi, unde, quo etj. Te fjalitë lidhore përdoret mënyra dëftore dhe lidhore.

Bonus nocet, qui malis parcat. Kush do që i mbron të këqinjët, u bën dëm të mirëve.

Ubi concordia regnat, homines sunt felices. Ku mbretëron bashkimi, njerëzit janë të lumtur. Kur përdoret mënyra lidhore në fjali përdoret lidhorja sipas consecutio temporum.

Missi sunt legati, qui (ut ii) pacem paterent. Legatët u dërguan që të kërkonin paqë.

Salutus es qui (cum tu) sine labore proficere cupias. Je i marrë, sepse dëshiron të përparosh pa mund. Pompei milites luxuriam obiciebant Caesaris exercitui, cui (cum ei) omnia fere necessaria defuissent. Ushtarët e Pompeit ia përfllitnin luksin ushtrisë së Cezarit, edhe pse kësaj i mungonin gati të gjitha gjërat e nevojshme.

Nihil adeo arduum est, quod (ut id) non virtute consequi possimus. Kurgjë nuk është aq e vështirë sa që mos të mundnin ta mërrinin me virtyte.

Inveniuntur, qui falso putent mundum interitum esse. Ka që mendojnë gabimisht, se bota do ta ketë fundin e vet.

Fjalitë përcaktore

Këto fjali shprehen me përemrat lidhor - qui, quae, quod (i cili, e cila, e cila gjë). Te këto fjali përdoret mënyrë lidhore, koha e të cilave zgjidhet sipas rregullave të përgjithshme që vlejné për fjalitë e varur rrethanore.

Fjalitë përcaktore në fjali mund të kenë vlerë: qëllimore, rrjedhore, shkakore, lejore dhe kushtore.

Dux legatos misit, qui (=utii) pacem peterent. Prijsi dërgoj legatët që të kërkonin paqë. Exegi monumentum quod (ut-id) Aquilo diruere non possit. Një të tillë përmendore i ngrita që as vetë Akuiloni nuk mund ta shkatërrojë.

O magna vis veritatis, quae (=cumea) facile se per se ipsa defendat. O forcë e madhe e së vërtetës që vetëm me lehtësi nëpërmjet vetes mbrohet.

Pompei milites exercitui Caesaris luxuriam obiciebant, cui (ei) semper omnia ad necessarium usum defuissent. Ushtarët e pompeit akuzonin për tepri ushtrin e Cezarit, të cilës i kish munguar gjithçka e domosdoshme.

Qui (=si quis) videret, urbem captam diceret. Sikur ta shihte kush, do të thoshte se qyteti u pushtua.

Fjalitë ndaluese ose të varura

Të gjithë fjalitë ndaluese ose të varura në ligjeratën e zhdrejtë janë në mënyrë lidhore. Dhe koha e tyre drejtohet sipas foljes dicendi ose sentiendi nga e cila varet ligjërata e zhdrejtë, dhe kjo sipas consesutio temporum.

Milites dicunt: "Omnia facimus, quae nobis imperata sunt. Ushtarët thonë: "Të gjitha që na janë urdhëruar i bëjmë.

Milites dicunt se omnia facere, quae sibi imperata sunt. Ushtarët thonë se i bëjmë të gjitha që u janë urdhëruar.

Fjalitë dyshuese

Orator exclamavit: "Quid turpis est quam mentiri" (nihil turpius est). Gostari bërtiti: Ç'është më e turpshme se rena.

Caesar respondit: "Num recentium iniuriarum memoriam deponere possum (non possum). cezari u përgjigj:

A thua mund t'i harroj padrejtësitë e ditëve të fundit.

Në gjuhën latine pyetjet e tilla në ,ligjëraten e drejtë në veten e parë dhe të tretë njëjës, të gjitha pyetjet në vetën e dytë janë pyetje të mirëfillta por dyshuese.

Këto fjali shprehin dyshim prandaj dhe quhen fjali dyshuese.

Fjalitë dëshirore

Fjalitë dëshirore gjenden në lidhore sipas consecutio temporum dhe në fjali urdhërore ku pjesëza mohuese është ne, por nëse vazhdon si mohuese neve.

Caesar milites allocutus est: Quid tandem veremini aut cur desperatis. Cezari iu drejtua ushtarëve: Nga ç'kemi frikë më në fund ose përse po e humbni shpresën.

Caesar milites allocutus est: quid tandem vererentur aut cur desperarent. Cezari iu drejtua ushtarëve nga çdo të kishin më në fund frikë ose përse ta humbnin shpresën.

Dux militibus: Signo dato, inquit, e castris erumpite. Udhëheqësi u tha ushtarëve: Nëse shenjën e dhënë shpërtheni nga kampi.

Dux militibus dixit: signo dato e castris e rumperent. Udhëheqësi u tha ushtarëve që në shenjën e dhënë të shpërthenin nga kampi.

Ligjërata e drejtë dhe e zhdrenjtë

Në gjuhën latine fjalët e huaja mund të thuhën në dy mënyra:

- a) në formë të njejtë, ashtu si e ka thënë autori ose ndonjë tjetër;
- b) me një formë të ngjashme, por me fjalë të folësit.

Mënyra e parë e të shprehurit quhet ligjëratë e drejtë - oratio recta, ndërsa mënyra e dytë ligjërata e zhdrenjtë oratio obliqua.

Në ligjëratën e drejtë folja është në mënyrën dëftore, ndërsa në ligjëratën e zhdrenjtë në mënyrën lidhore.

Pater liberis dicit: Labor necessarius est. Babai u thotë fëmijëve: Puna është e nevojshme.

Pater liberis dicit laborem necessarium esse. babai u thotë fëmijëve që puna është e nevojshme.

RECETA - RECEPTUM

Recetë quhet porosia me shkrim e mjekut (praescriptio medica), sipas të cilës në farmaci t'i pregaditet dhe ti jepet të sëmurit bari i caktuar. Fjala recetë vjen nga folja recipio (marr). Ndryshe në latinisht quhet edhe Formula remediorum (formulë barash).

Receta është dokument zyrtar me rëndësi juridike dhe nuk lejohet përmirësimë në të nga ana e personave jo kompetend, pra vetëm mjeku shënon recetë.

Paraqitja e jashtme e recetës

Receta shënohet me ngjyrë, është letër e bardhë zakonisht 14/10cm. Në një fletë duhet të shënohet një recetë. Në qoftë se është e nevojshme që në fletë të shënohen disa receta, atëherë ato ndahen midis tyre me shenjën #. Dhe në qoftëse njëra faqe e fletës nuk mjafton atëherë në fund të faqes së parë shënohet folja verte (ktheje), ose shkurt "V". Receta shkruhet në fletë recetash të atij institucioni mjekësor ku punon mjeku, në to shënohen edhe emri i institucionit që i vërteton ato me vulën e vet.

PJESA LATINE E RECETËS

Rasa gjinore e sasisë (genitivus quantitatis)

Pjesa latine e recetës fillon me fjalën "Recipe", shkurt Rp. (merr). Pas kësaj vjen pjesa kryesore e recetës: tregohen lëndët medikamentoze që nevojiten për pregaditjen e barit. Çdo lëndë shkruhet në kryeradhë dhe me shkronjë të madhe shkruhen edhe emrat e bimëve mjekësore, kurse cilësia e tyre me germë të vogël. Peshat e barit shënohet me shifra arabe në gram, decigram, centigram, miligram etj. Kur bari shënohet me pika, sasia e pikave shënohet me shifra romake. (guttae III). Nëse jepen dy ose më shumë lëndë medikamentoze shënohet kur sasia është e njejtë, para saj shënohet ana - shkurt \overline{aa} (barabart, nga). Receta vetëm me një lëndë quhet e thjeshtë, kurse kur përbëhet prej më shumë lëndësh quhet e përbërë.

Bari i recetës vihet në rasën gjinore, kurse sasia e tij në rasën kallëzore. Pjesa latine e recetës mbaron me fjalët:

Misce (përziej) ose Misceatur (të përziejhet)

Da (jep) ose Detur (të jepet), Dentur (të jepen)

Signa (shëno) ose Signetur (të shënohet) (shkurt M.D.S.)

Përbërja e recetës

1. Inscriptio (mbishkrimi). Në këtë pjesë shënohet emri i institucionit mjekësor, dega, reparti, numri i regjistrimit.
2. Nomen aegroti (emri i të sëmurit). Në këtë pjesë shënohet emri dhe mbiemri i të sëmurit, masha dhe adresa e tij.
3. Invocatio ose praepositio (të drejtuarit). Kjo pjesë përbën porosin e mjekut drejtuar farmacistit. Kjo shprehet me formën urdhërore. "Recipio" (merr) dhe zakonisht shkruhet Rp.

4. Designatio materialiarum ose ordinatio (përshkrimi i lëndëve). Kjo është pjesa kryesore e recetës, ku tregohen lëndët që marrin pjesë në përgaditjen e barërit.
5. Subscriptio (nënshkrimi ose udhëzimi). Kjo pjesë fillon me fjalët Misce. Da (shkurt M.D.) ose Misceatur, Detur (përziej, jep ose të përziej, të jepet).
6. Signatura (të shënuarit). Kjo pjesë e recetës fillon me fjalën latine: Signa, Signetur (shkurtimisht S) domethënë shëno ose të shënohet.
7. Nomen medici (Emri i mjekut). Këtu shënohet emri i mjekut, vihet firma e tij, vula dhe data.

Në qoftë se mjeku e shënon recetën për vete, në fund të recetës shënohet: pro me (për mua), pro auctore (për autorin), ad usum proprium ose pro usu proprio (për përdorim vetiak) etj.

Nëse bari nevojitet shumë shpejtë atëherë në krye të recetës shënohet; Cito (shpejt, citissime (shumë shpejt), statim (aty për aty)).

Model i një recete të përbërë

POLIKLINIKA QENDRORE	Dega.....	} inscriptio
Reparti.....	Nr. regj.....	}
Emri i të sëmurit		} Nomen aegroti
vjeç.....	Adresa.....	}
Rp.:		} invocatio
Basis {	codeini phosphorici 0,15	} materiarum
	Ammonii bromati	
Remedium {	Kalli bromati	
adiuvans {	Natrii bromati aa. 3.0.	
Remedium {	Aquae Menthae piperitae 20,0	
corrigenes {		
Remedium {	Aqua destillatae ad 200,0	
constituens {		
	Misce. Da	Subscriptio
	Signa. Nga një lugë gjelle	
	2-3 herë në ditë	signatura
Data.....	Mjeku	} nomen medici

TRAJTAT E FOLJEVE TË RREGULLTA

ZGJEDHIMI I OSE A: laudo, laudare, laudatum

	VEPRORJA		
		Mënyra dëftore	Mënyra lidhore
TRAJTAT E SË TASHMES	Koha e tashme	laudo (lëvdoj) lauda - s lauda- t lauda -mus lauda -tis lauda -nt	lauda - m (lë lëvoj) laude-s laude-t laude-mus laude-tis laudent
	Koha e pakryer	lauda-ba-m (lëvdoja) lauda-ba-s lauda-ba-t lauda-ba-mus lauda-ba-tis lauda-ba-nt	lauda-re-m (të lëvdoja) lauda-re-s lauda-re-t lauda-re-tis lauda-re-nt
	koha e ardhshme	lauda-bo (do të lëvdoj) lauda-bi-s lauda-bi-t lauda-bi-tis lauda-bu-nt	
	emrat foljorë mënyra urdhërore	I njëj. lauda! (lëvdoj) shum. laudate II. njëj. lauda-to lauda-to shum. lauda-tote lauda-nto	
	Paskajorja e së tashme: laudare-(për t'u lëvduar)		
	Pjesorja e së tashmes: lauda-ns, laudantis - (lëvdues)		

		PËSORJA		
		Mënyra dëftore	Mënyra lidhore	
TRAJTAT E TEMËS TË SË TASHMES	Koha e tashme	laudo-r (lëvdohem) lauda-ris lauda-tur lauda-mur lauda-mini lauda-ntur	laude-r laude-ris laude-tur laude-mur laude-mini laude-ntur	
	koha e pakryer	lauda-ba-r (lëvdohesha) lauda-ba-ris lauda-ba-tur lauda-ba-mur lauda-ba-mini lauda-ba-ntur	lauda-re-r(të lëvdohesha) lauda-re-ris lauda-re-tur lauda-re-mur lauda-re-mini lauda-re-ntur	
	koha e ardhshme	lauda-bo-r (do të lëvdohem) lauda-be-ris lauda-bi-tur lauda-bi-mur lauda-bi-mini lauda-bu-ntur		
	mënyra urdhërore	nuk përdoret		
	emrat foljor	Paskajorja e së tashmes: laudari-(për t'u lëvduar)		
		Gjerundivi: lauda-ndus-a,-um (ai, që duhet të lëvdohet)		

TRAJTA E TEMËS TË SË KRYERËS		VEPRORJA	
		Mënyra dëftore	Mënyra lidhore
	Koha e kryer	laudav-i (kam lëvduar) laudav-isti laudav-it laudav-imus laudav-istis laudav-erunt	laudav-eri-m (të kem lëvduar) laudav-eri-s laudav-eri-t laudav-eri-mus laudav-eri-tis laudav-eri-nt
	koha e kryer e plotë	laudav-era-m (kisha lëvduar, pata lëvduar) laudav-era-s laudav-era-t laudav-era-mus laudav-era-tis laudav-era-nt	laudav-isse-m (të kisha lëvduar) laudav-isse-s laudav-isse-t laudav-isse-mus laudav-isse-tis laudav-isse-nt
	koha ardhshme e përparshme	laudav-er-o laudav-eri-s laudav-eri-t laudav-eri-mus laudav-eri-tis laudav-eri-nt	
	Paskajorja e së kryerës: laudavisse - për tu lëvduar		

		VEPRORJA	
		Mënyra dëftore	Mënyra lidhore
TRAJTAT E TEMËS SË PËSORES (SUPINIT)	koha e tashme	mone-o (qortoj) mone-s mone-t mone-mus mone-tis mone-nt	mone-a-m (të qortoj) mone-a-s mone-a-t mone-a-mus mon-a-tis mone-a-nt
	koha e pakryer	mone-ba-m (qortoja) mone-ba-s mone-ba-t mone-ba-mus mone-ba-tis mone-ba-nt	mone-re-m (të qortoja) mone-re-s mone-re-t mone-re-mus mone-re-tis mone-re-nt
	koha e ardhshme	mone-bo (do të qortoj) mone-bi-s mone-bi-t mone-bi-mus mone-bi-tis mone-bu-nt	
	mënyra urdhërore	I. njejës mone (qorto) shumës mone-te II. njejës mone-to mone-to shumës mone-tote mone-nto	
	emrat foljorë	Paskajorja e së tashme: mone-re (për t'u qortuar)	
Pjesorja e së tashme: mone-ns, mone-ntis (qortues)			

TRAJTAT E TEMËS SË TASHME		PËSORJA	
		Mënyra dëftore	Mënyra lidhore
	koha e tashme	mone-o-r (qortohem) mone-ris mone-tur mone-mur mone-mini mone-ntur	mone-a-r (të qortohem) mone-a-ris mone-a-tur mone-a-mur mone-a-mini mone-a-ntur
	koha e pakryer	mone-ba-r (qortohesha) mone-ba-ris mone-ba-tur mone-ba-mur mone-ba-mini mone-ba-ntur	mone-re-r (të qortohesha) mone-re-ris mone-re-tur mone-re-mur mone-re-mini mone-re-ntur
	koha e ardhshme	mone-bo-r (do të qortohem) mone-be-ris mone-bi-tur mone-bi-mur mone-bi-mini mone-bu-ntur	
	mënyra urdhërore	nuk përdoret	
	emrat foljorë	Paskajorja e së tashme: mone-ri (për t'u qortuar)	
	Gjerundivi: mone:ndus, -a-um (ai, që duhet të qortohet)		

	VEPRORJA		
	Mënyra dëftore	Mënyra lidhore	
TRAJTA E TEMËS TË SË KRYERËS	koha e kryer	<p>monu-i (qortova, kam qortuar)</p> <p>monu-isti</p> <p>monu-it</p> <p>monu-imus</p> <p>monu-istis</p> <p>monu-erunt</p>	<p>monu-eri-m (të kem qortuar)</p> <p>monu-eri-s</p> <p>monu-eri-t</p> <p>monu-eri-mus</p> <p>monu-eri-tis</p> <p>monu-eri-nt</p>
	koha e kryer e plotë	<p>monu-eram (kisha qortuar, pata qortuar)</p> <p>monu-eram</p> <p>monu-era-s</p> <p>monu-era-t</p> <p>monu-era-mus</p> <p>monu-era-bis</p> <p>monu-era-nt</p>	<p>monu-isse-m (të kisha qortuar)</p> <p>monu-isse-m</p> <p>monu-isse-s</p> <p>monu-isse-mus</p> <p>monu-ise-tis</p> <p>monu-isse-nt</p>
	koha e ardhshme e përparme	<p>monu-ero (do të kem qortuar)</p> <p>monu-eri-s</p> <p>monu-eri-t</p> <p>monu-eri-mus</p> <p>monu-eri-tis</p> <p>monu-eri-nt</p>	
	emrat foljor	Paskajorja e së kryerës: monu-isse	

		PËSORJA	
		Mënyra dëftore	Mënyra lidhore
TRAJTAT E TEMËS SË PËSORËS (OSE SUPINIT)	koha e kryer	monitus, a, um sun (jam qortuar u qortova) est es moniti -ae, a sumus estis sunt	monitus -a, -um sim (të jem qortuar) sis sit moniti -ae, a simus sitis sint
	koha e kryer e plotë	eram (isha qortuar) eras erat eramus eratus erant	monitus - ae, a essem (të isha qortuar) esses esset moniti - ae, -a essemus essetis essent
	koha e ardhshme e përparshme	monitus a, -um ero (do të jem qortuar) eris erit moniti - ae, a erimus, eritis, erunt	
	emrat foljorë	Pjesorja e së kryerës: monitus, -a-um	
Paskajorja e së kryerës: monitum, -am -um esse			
Pjesorja e së ardhmes: veprorë: moniturus, a -um			
Paskajora e së ardhmes veprorë: moniturum -am-um esse			

ZGJEDHIMI III OSE KONSON: *lego, legere, legi, lectum*

		VEPRORJA	
		Mënyra dëftore	Mënyra lidhore
TRAJTAT E TEMËS TË SË TASHMES	koha e tashme	leg-o (lexoj) leg-i-s leg-i-t leg-i-mus leg-i-tis leg-u-nt	leg-a-m (të lexoj) leg-a-s leg-a-t leg-a-mus leg-a-tis leg-a-nt
	koha e pakryer	leg-e-ba-m (lexoja) leg-e-ba-s leg-e-ba-t leg-e-ba-mus leg-e-ba-tis leg-e-ba-nt	leg-e-re-m (të lexoja) leg-e-re-s leg-e-re-t leg-e-re-mus leg-e-re-tis leg-e-re-nt
	koha e arshme	leg-a-m (do të lexoj) leg-e-s leg-e-t leg-e-mus leg-e-tis leg-e-nt	
	mënyra urdhërore	I. njëjës leg-e (lexo!) shumës leg-i-te II. njëjës leg-i-to leg-i-to shumës leg-i-tote leg-u-nto	
	emrat foljorë	Paskajorja e së tashmes: leg-e-re	
		Pjesorja e së tashmes: leg-e-ns, leg-e-ntis	

		PËSORJA	
		Mënyra dëftore	Mënyra lidhore
TRAJTAT E TEMËS TË SË TASHMES	koha e tashme	leg-o-r (lexohemi) leg-e-ris leg-i-tur leg-i-mur leg-i-mini leg-u-ntur	leg-e-r (të lexohem) leg-a-ris leg-a-tur leg-a-mur leg-a-mini leg-a-ntur
	koha e pakryer	leg-e-ba-r (lexohesha) leg-e-ba-ris leg-e-ba-tur leg-e-ba-mur leg-e-ba-mini leg-e-ba-ntur	leg-e-re-r (të lexohesha) leg-e-re-ris leg-e-re-tur leg-e-re-mur leg-e-re-mini leg-e-re-ntur
	koha e ardhme	leg-a-r (do të lexohem) leg-e-ris leg-e-tur leg-e-mur leg-e-mini leg-e-ntur	
	mënyra urdhërore	Nuk përdoret	
	emrat foljorë	Paskajorja e së tashmes: leg-i	
		Gjerundivi: leg-e-ndus, -a, um	

TRAJTAT E TEMËS TË SË KRYERËS		VEPRORJA	
		Mënyra dëftore	Mënyra lidhore
	koha e tashme	leg-i (kam lexuar, lexova) leg-isti leg-it leg-imus leg-istis leg-erun	leg-eri-m (të kem lexuar) leg-eri-s leg-eri-t leg-eri-mus leg-eri-tis leg-eri-nt
	koha e kryer e plotë	leg-era-m kisha lexuar (pata lexuar) leg-era-s leg-era-t leg-era-mus leg-era-tis leg-era-nt	leg-isse-m (të kisha lexuar) leg-isse-s leg-isse-t leg-isse-mus leg-isse-tis leg-isse-nt
	koha e ardhme e përparme	leg-ero (do të kem lexuar) leg-eri-s leg-eri-t leg-eri-mus leg-eri-tis leg-eri-nt	
	emra foljorë	Paskajorja e së kryerës: leg-isse	

		PËSORJA			
		Mënyra dëftore	Mënyra lidhore		
TRAJTAT E TEMËS SË PJESORES (OSE SUPINIT)	koha e kryer	lectus, -a, um	{ sum (jam lexuar) es est	lactus, -a, -um	{ sim (të jem lexuar) sis sit
		lacti -ae, -a	{ sumus estis sunt	lecti, -ae, -a	{ simus sitis sint
	koha e kryer e plotë	lectus, -a, um	{ eram (isha lexuar) eras erat	lactus, -a, -um	{ essem (të lexuar) esses esset
		lacti -ae, -a	{ eramus eratis erant	lecti, -ae, -a	{ essemus esetis essent
	koha e ardhme e përparme	lectus, -a, um	{ ero (do të jemë lexuar) eris erit		
		lecti -ae, -a	{ erimus eritis erunt		
emrat foljorë		Pjesorja e së kryerës: lectus; -a, um			
		Paskajorja e së kryerës: lectum, -am, um esse			
		Pjesorja e së ardhmes veprorë: lecturus, -a, -um			
		Paskajorja e së ardhmes veprorë: lecturum, -am, -um esse			

ZGJEDHIMI IV OSE I: *audio, audire, audivi, auditum*

		VEPRORJA	
		Mënyra dëftore	Mënyra lidhore
TRAJTAT E TEMËS SË TASHME	koha e tashme	audi-o (dëgjoj) audi-s audi-t audi-mus audi-tis audi-u-nt	audi-a-m (të dëgjoj) audi-a-s audi-a-t audi-a-mus audi-a-tis audi-a-nt
	koha e pakryer	audi-e-ba-m (dëgjoja) audi-e-ba-s audi-e-ba-t audi-e-ba-mus audi-e-ba-tis audi-e-ba-nt	audi-re-m (të dëgjoja) audi-re-s audi-re-t audi-re-mus audi-re-tis audi-re-nt
	koha e ardhme	audi-a-m (do të dëgjoj) audi-e-s audi-e-t audi-e-mus audi-e-tis audi-e-nt	
	mënyra urdhërore	I. njëjës audi (dëgjo!) shumës audi-te II. njëjës audi-to audi-to shumës audi-tote audi-u-nto	
	emrat foljorë	Paskajorja e së tashmes: audire	
Pjesorja e së tashmes: audi-ens, audi-entis			

TRAJTAT E TEMËS TË SË TASHME		VEPRORJA	
		Mënyra dëftore	Mënyra lidhore
	koha e tashme	audi-o-r (dëgjothem) audi-ris audi-tur audi-mur audi-mini audi-u-ntur	audi-a-r (të dëgjothem) audi-a-ris audi-a-tur audi-a-mur audi-a-mini audi-a-ntur
koha e pakryer	audi-e-ba-r (dëgjothesha) audi-e-ba-ris audi-e-ba-tur audi-e-ba-mur audi-e-ba-mini audi-e-ba-ntur	audi-re-m (të dëgjothesha) audi-re-ris audi-re-tur audi-re-mur audi-re-mini audi-re-ntur	
koha e ardhme	audi-a-r (do të dëgjothem) audi-e-ris audi-e-tur audi-e-mur audi-e-mini audi-e-ntur		
emrat foljorë	Paskajorja e së tashmes: audi		
	Gjerundivi: audi-e-ndus, -a, -um		

TRAJTAT E TEMËS TË SË KRYERËS		VEPRORJA	
		Mënyra dëftore	Mënyra lidhore
	koha e kryer	adiv-i (dëgjova, kam dëgjuar) adiv-isti adiv-it adiv-imus adiv-istis adiv-verunt	adiv-eri-m (të kem dëgjuar) adiv-eri-s adiv-eri-t adiv-eri-mus adiv-eri-tis adiv-eri-nt
	koha e kryer e plotë	adiv-era-m (kisha dëgjuar pata dëgjuar) adiv-era-s adiv-era-t adiv-era-mus adiv-era-tis adiv-era-nt	adiv-isse-m (të kisha dëgjuar) adiv-isse-s adiv-isse-t adiv-isse-mus adiv-isse-tis adiv-isse-nt
	koha e ardhme e përparme	adiv-ero (do të kem dëgjuar) adiv-eri-s adiv-eri-t adiv-eri-mus adiv-eri-tis adiv-eri-nt	
emrat foljorë	Paskajorja e së kryerës: puniv-isse (për të pas dëgjuar)		

		PËSORJA	
		Mënyra dëftore	Mënyra lidhore
TRAJTAT E TEMËS SË PJESORES (OSE SUPINIT)	koha e kryer	auditus, -a, um { sum (jam dëgjuar u dëgjova) es est { sumus estis sunt { sim (të jem dëgjuar të kem qenë dëgjuar) sis sit { simus sitis sint	auditus, -a, -um { sis sit { simus sitis sint
	koha e kryer e plotë	auditus, -a, um { eram (isha dëgjuar) eras erat { eramus eratis erant { essem (të isha dëgjuar) esses esset { essemus esetis essent	auditus, -a, -um { eras erat { eramus eratis erant { essem (të isha dëgjuar) esses esset { essemus esetis essent
	koha e ardhme e përparme	auditus, -a, um { ero (do të jemë lexuar) eris erit { erimus eritis erunt	auditus, -a, um { ero (do të jemë lexuar) eris erit { erimus eritis erunt
	emrat foljorë	Pjesorja e së kryerës: auditus; -a, um Paskajorja e së kryerës: auditum, -am, um, esse Pjesorja e së ardhmes veprorë: auditurus, -a, -um Paskajorja e së ardhmes veprorë: auditurum, -am, -um esse	

FJALOR LATINISHT - SHQIP

A

a, ab, abs (+Abl.) - prej, nga, që
accedo 3, accessi, - cessum- afrohem, qasem
accido 3, accidi, - ndodh, ngjaj, arrij
accipio 3, accepi, - ceptum- marr, pranoj
acer, acris, acre - i mprehtë, i fortë, i rrebtë
acies, aciei f.- mprehtësi
ad (+Akk.) - për, te
ad triginta milia - për tridhjetë milja
adduco 3, adduxi, ductum- sjell, çoj, përcjell;
afroj
adeo, -is, -ire, adii - itum- përcjej, kthen
adfero, - fers, - ferre, attuli, allatum- thërmoj,
grimcoj, imtësoj
adipiscor, -eris, -i, - arrij, nxjerr, fitoj
adiungo 3, adiunxi, - iunctum- bashkoj, ngjes
adorior 4, adortus -sum - sulmoj, ndërmar
adpropinguo 1- shpejtoj, nxitoj
adulescens, - adolehent, djal i ri
adulescentis m. - adolehentët, djaloshët
adventus m. - i vënë përballë, i papëlqyeshëm
ager, agri m. - i sëmurë
agmen, agminis m. - shumicë, mizer, turmë
ago 3, egi, actum - çoj, bëj, punoj
alienus, - a, - um - i huaj
alii, - ae, -a (pl.) - gjëti
aliqui, aliqua, aliquod - dikush, ndonjë
alius, alia, aliud - tjetër, një tjetër
alo 3,alui, atlum - ushqej, mbaj, rris
alter altera alterum - njëri nga të dy, njëri
...tjetri
altus, -a, -um - i lartë i thellë
amica, -ae f. - shoqe, mike
amicitia, ae f. - shoqe, mike
amicus, -i m. - mik, shok
amitto 3. amisi, misum - humb, humbas
amplus, -a, -um - i gjërë, i hapët
amplissima familia - familje e lartë
animadverto 3, animadverti, versus - i gat-
shëm, i gjallërueshëm
animus, -i m. - frymë, shpirtë
annus, -i m. - vjet
ante - para, përpara
ante (+Akk) - para
antea - përpara, më përpara
apello 1 - quaj, thëras, emëroj
apud (+Akk) - pranë
aqua, - ae f. - ujë
aquila, - ae f. - shqiponjë, shqipe
arbitror 1 - mendoj, marr parasyshë, besoj
arma, -orum n.Pl. - armë

armatus, -a, -um - armaturë
ars, artis f. - art, mjeshtri, aftësi
at - por, veç, megjithatë
atque /ac - edhe, gjithashtu, veç asaj
atrox (Gen.: atrocis) - i pazier, i egër
auctor, auctoris m. - aktor, shkaktar
auctoritas - garanci, kredi
auctoritatis f. - autoritet
audeo 2, ausus sum (!) - guxoj, rrezikohem
audio 4 - dëgjoj
augeo 2, auxi, - rris, shtoj
auctum - rris, shtoj
auctum - rritje, shtim
aut - ose
aut...aut - ose...ose
autem - por, mirëpo, përkundrazi
auxilium, -i n. - ndihmë, mjet shërimi
auxilia, orum n.Pl. ndihmojë, mjete shërimi
avaritia, ae f. - kopraci, pangopësi

B

bello 1 - luftoj, bëj luftë
bellum, -in - luftë,
bellum gevere - bëj luftë
bellum inferre - sjell luftë
bene - mirë, drejtë
beneficium, -i n. punë, e mirë, shërbim
bonus, -a, -um - i mirë
brevis, breve - i shkurtër, i vogël
brevi - gati, tash

C

caedes, caedis f. - vrasje, prerje, kërdi
caelum, -i n. - qiell
Caesar, caesaris m. - Cezari, pris ushtarak
romak
calamitas, - fatkeqësi rrezik
calamitatis f. - i dëmshëm, fatkeqësisht
campus, -i m. fushë, shesh
capio 3, cepi, captum - kap, marr, pushtoj
captivus, -i m. rob, i zënë rob
caput, capitis n. - kokë, krye
castra, - orum n. - llogore, shatore, kamp
ushtarak
casus, casus m. - rrënjë, rasë, ngjarje
causa - shkak
causa, - ae f. - arsye, burim, shkak
cedo 3, cessi, cessum - bie
celer, celeris, celere i shpejtë, i shkathët
celeritas, celeritatis f. - shpejtësi
centum - njëqind

cerno 3, crevi, - ndaj, veçoj
cretum - i sigurt
certe, ceteri, - ae, -a - të tjerët
circuitus, circuitus m. - rrotullim, rreth
circum (+Akk) rreth, për rreth
circumsisto 3 - qëndroj, rri
circumsteti, - qëndroj, rri
circumvenio 4 - vij për rreth
civis, civis m. - qytetar
civitas, civitatis f. - qytet
civitas civitatis f. - shtet
clamor, clamoris m. - bërtas
coepi, isti, - isse - filloj, ia nis, zë
cognosco 3, cognovi, gnitum- njoh, di
cogo 3, coegi, - actum - mbledh, grumbulloj
collis, collis m. - kodër, kodrinë
comes, comitis m. - përcjellës, ndjekës
commemoro 1, committo 3, commisi, -
 missum - besoj, mbështes
comparo 1 - përgadis, mbledh
compleo, -es, - ere, mbush, përmbush
complevi, - pletum - shumë sosh, shumica
complures (m..f.PI), shumë lojsh
complura (n.PI)
concedo 3, concessi, - cossum- largohem,
 nisem
concurro 3, concurri, - vrrapoj, rend, kërkoj
cursum, cinsidio,
condicionis f. - pozitë gjendje, kusht
 (confero, fers, - ferre, - ngarkoj, çoj,
 përmbledh, ndërtoj
contuli, collatum)
 se conferre
conficio, -is, - ere, - bëj, pregadis
confici, fectum - çpifje, trillim
confido 3, confisus - thyej, çaj
 sum (!)
confirmo 1. - forcoj, përforcoj
conicio 3, conieci, - hedhë flakë, vërris
 - iectum
conor 1 - përpiqem, orvatem
consequor, sequeris, - ndjek direkt, shkoj
 pas
 sequi, consecutus
 sum (+Akk)
consido 3, consedi, - ulem, zë vend, rrij
 sessum
consitium, - i n. - këshiell, kuvend
consisto 3, constiti, conspectus - përbëhem,
 qëndroj
conspectus m. pamje, dukje
conspicio, -is, -ere, shikoj, vërej
conspexi, spectum,

conspicor 1 - shikoj, vërej, dalloj
constituo 3, constitui, stitulum - vë vendos
consuesco 3, mësehem
consuevi, - suelum - i mësuar
consul, consulis m. - konsull
consumo 3, consumpsi, - sumptum -
 shpenzoj, përdor, shkatërroj
contendo 3. contendi, - shtrij, ngre
 tentum
contra (+Akk) - përball, kundër
controversia, ae f. - grindje
convenio 4, conveni - mblihem
 ventum
converto 3, converti, - kthej, drejtohem
 versum
convoco 1 - thërras, mbledh
copia, - ae f. - begati, bollëk
corpus, corporis n - trup
credo 3., credidi, - besoj
cuius? i kujt?
cultus, cultus m. - punim toke
cum (+Abl.) - me, bashkë me
cum (+Konj) - me
cupiditas, - dëshirë e flaktë, e eptsh. lakmi
cupiditatis f. - shfrytëzim, ambicje
cupidus, - a, -um - lakmues, dëshirues
cur - pse? përse?
cura, - ae f. - kujdes, zell
custodia, - ae f. mbikqyrje, rroje

D

